

VËLLIMI X XIII /KORRIK - SHTATOR/ 2023

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2023**

BULETINI ZYRTAR

PËRMBAJTJA

Nr.994 Datë 05.07.2023	5
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AIR BP ALBANIA SHA NGA SHOQËRITË BP HOLDINGS INTERNATIONAL B.V. DHE UNITED WORLD TECHNOLOGIES B.V.”	
Nr. 995, Datë 05. 07. 2023	8
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AMB CONSTRUCTION SHPK NGA SHOQËRITË AGNA SHA, INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”.	
Nr. 996, Datë 05. 07. 2023	11
“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE AGNA SHA, INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AMB CONSTRUCTION SHPK”.	
Nr. 997, Datë 05. 07. 2023	14
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË KUOTAVE TË SHOQËRISË PARQUE EÓLICO LITUECHE SPA NGA SHOQËRIA EMPRESA ELÉCTRICA PILMAIQUÉN S.A.”.	
Nr. 998, Datë 05. 07. 2023	17
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË DREJTPËRDREJTË DHE TË TËRTHORTË TË SHOQËRISË INFOFOT SYSTEMS SHPK NGA Z. ARMAND SHARRA.	
Nr. 999, Datë 05.07. 2023	20
“PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM NË KRYERJEN E DETYRAVE FUNKSIONALE TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM” .	
Nr. 1000, Datë 17. 07.2023	21
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE RAIMONDO G.P SHPK DHE LI.BO-ALBANIA BRANCH SHPK”.	
Nr.1001, Datë 17.07. 2023	24
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË KUOTAVE TË SHOQËRIVE GGE IRELAND LIMITED DHE EMP ENERGY LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IRELAND LIMITED”.	

Nr. 1004, Datë 20. 07. 2023	27
“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI NË PËRLLOGARITJE TË GJOBËS SË VENDOSUR SHOQËRISË TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK ME VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURENCËS NR. 996 DATË 05.07.2023 “PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE AGNA SHA, INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AMB CONSTRUCTION SHPK”.	
Nr. 1005 , Datë 28. 07. 2023	30
“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË AIR BP ALBANIA SHA PËR DEKLARIM TË TË DHËNAVE TË PAPLOTA DHE TË PASAKTA”	
Nr. 1006 , Datë 28.07. 2023	34
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE EÓLICA CQN UNO SPA DHE EÓLICA CQN DOS SPA NGA SHOQËRIA EMPRESA ELÉCTRICA PILMAIQUÉN S.A.”	
Nr. 1007 , Datë 29. 08. 2023	38
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË CIRCOR INTERNATIONAL, INC. NGA KKR & CO, INC. NËPËRMJET SHOQËRISË CUBE BIDCO, INC”.	
Nr. 1008 , Datë 29.08. 2023	41
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË EFACEC POWER SOLUTIONS, SGPS S.A. NGA SHOQËRIA MUTARES SE & CO. KGAA.”.	
Nr. 1009 , Datë 29. 08. 2023	45
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE GGE IRELAND LIMITED DHE EMP ENERGY LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IRELAND LIMITED”.	
Nr. 1010 , Datë 29. 08. 2023	49
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELGI SHPK NGA SHOQËRIA SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK”.	
Nr. 1011 , Datë 13.09. 2023	53
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË MESSER SE & CO. KGAA DHE TOYOTA TSUSHO EUROPE”.	
Nr. 1012 , Datë 13.09. 2023	57
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VRUMONA B.V. NGA SHOQËRIA ROYAL UNIBREW A/S NËPËRMJET SHOQËRISË COMPANY OF JUNE 2023 B.V.”	

Nr. 1014, Datë 21.09.2023	69
“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PRODHIMIT, TRANSMETIMIT DHE SHITJES NË MËNYRË DIXHITALE TË PRODUKTEVE AUDIO DHE VIDEO, TEK OPERATORËT KABLLORË (Ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor)”.	
Nr. 1015 , Datë 21.09. 2023	77
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË D WAY DOO NGA SHOQËRIA NELT CO. DOO BEOGRAD DHE PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË D WAY NGA SHOQËRIA NEREGELIA”	
Nr. 1016 , Datë 21.09. 2023	80
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE MHB WIND FARMS (HOLDINGS) LIMITED DHE TAURBEG LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IRELAND LIMITED.”	
Nr. 1018 , Datë 29.09. 2023	83
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË BOSIS DOO VALJEVO NGA SHOQËRIA DS SMITH PACKAGING SOUTH EAST GMBH”.	
Nr. 1019 , Datë 29.09. 2023	86
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË SAUDI ARABIAN OIL COMPANY, BAOSHAN IRON & STEEL CO., LTD. DHE PUBLIC INVESTMENT FUND.”	
Nr.1020 , Datë 29.09. 2023	89
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË ASETIVE TË BIZNESIT NË TOKË TË SHOQËRISË WINNS AS NGA SHOQËRIA STATKRAFT VARME AS.”	

VENDIM

Nr.994 Datë 05.07.2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AIR BP ALBANIA SHA NGA SHOQËRITË BP HOLDINGS INTERNATIONAL B.V. DHE UNITED WORLD TECHNOLOGIES B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni në lidhje me përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.

Referuar dokumentit “Marrëveshje e shitjes së aksioneve”, palët janë:

Pala Blerëse: United World Technologies B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti: të përvetësojë dhe disponojë pjesëmarrje ose interesa të tjera në organet e korporatave; të ofrojë këshillim në fushën e menaxhimit; të japë ose të prokurojë dhënien e kredive, në veçanti - por jo ekskluzivisht - për shoqëritë e lidhura, filialet ose shoqëritë në të cilat shoqëria ka interesa etj.

United World Technologies B.V. zotërohet tërësisht nga Stichting Administratiekantoor United World

Technologies, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit holandez, aktive në sektorin e pronave financiare.

Pala Shitëse: BP Holdings International B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti: të marrë pjesë, të financojë, të bashkëpunojë, të udhëheqë menaxhimin e kompanive dhe ndërmarrjeve të tjera etj.

BP Holdings International B.V. zotërohet nga aksionari i saj i vetëm BP Europe SE. BP Holdings International B.V. dhe BP Europe SE janë pjesë e Grupit BP.

Shoqëria Target: AIR BP ALBANIA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprime biznesi në fushën e tregtimit me shumicë të lëndëve djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive, si dhe karburanteve për avionë dhe mjete motorike etj.

Shoqëria AIR BP ALBANIA SHA, përpara transaksionit zotërohej 100% nga shoqëria BP Holdings International B.V.

II. Përqendrimi

Shoqëritë United World Technologies B.V. (blerësi) dhe BP Holdings International B.V. (shitësi), kanë lidhur “Marrëveshjen e shitjes së aksioneve”. Referuar Marrëveshjes së shitjes së aksioneve, BP Holdings International B.V. ka shitur dhe United World Technologies B.V. ka blerë 50% të aksioneve në shoqërinë United World Technologies B.V.

Aktualisht shoqëria target AIR BP ALBANIA SHA zotërohet 50% nga United World Technologies B.V. dhe 50% nga BP Holdings International B.V.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i përfundimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holding International B.V. dhe United World Technologies B.V. përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Shoqëria AIR BP ALBANIA SHA ofron prej 20 vitesh shërbimin e furnizimit me karburant të avionëve që operojnë në aeroportin e Rinasit dhe së fundmi edhe në aeroportin e Kukësit.

Nëpërmjet marrëveshjes së datës 24.02.2009 “Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”, të lidhur mes Tirana International Airport SHPK (TIA) dhe AIR BP ALBANIA SHA, kjo e fundit ka gëzuar për shumë vjet ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të furnizimit më karburant të operatorëve të linjave ajrore që operojnë në këtë aeroport.

Referuar aktivitetit të shoqërisë target, nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimit të furnizimit më karburant për avionë dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Aeroporti Ndërkombëtar Nënë Tereza, Rinas dhe Aeroporti i Kukësit.

Bazuar në të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për importet e realizuara në tregun e karburanteve, për periudhën 2017-2021, u konstatua se gjatë vitit 2017 dhe 2018, AIR BP ALBANIA SHA ka qenë e vetmja ndërmarrje e cila ka realizuar import të karburantit për avion JET A-1, si dhe e vetmja ndërmarrje e cila ofronte shërbimin e furnizimit me karburant pranë aeroportit të Rinasit (TIA-s).

Që prej vitit 2019 në Aeroportin Ndërkombëtar Nënë Tereza, AIR BP ALBANIA SHA nuk është operator ekskluziv. Ndërmarrja AV INTERNATIONAL GROUP - SHA zotëron rreth xx % të tregut në vitin 2021 dhe sipas deklaratës së palës njoftuese, kjo ndërmarrje për vitin 2022 zotëron më shumë se xx % të tregut, duke furnizuar më shumë fluturime dhe një portofol më të gjerë klientësh, i cili është zgjeruar vit pas viti, që nga 2019 kur ka nisur si operator furnizimi pranë Aeroporti Ndërkombëtar Nënë Tereza, Rinas.

Aktualisht shoqëria AIR BP ALBANIA SHA operon me kontratë ekskluzive në Aeroportin e Kukësit.

Transaksioni i propozuar do të sjellë përfundimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holding International B.V. dhe United World Technologies B.V.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria AIR BP ALBANIA SHA do të zotërohet 50% nga BP Holding International B.V. dhe 50% nga United World Technologies B.V.

United World Technologies B.V. nuk ka degë apo filial në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim në strukturën e tregut të shërbimit të furnizimit me karburant JET A-1 për avionët në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 56 pika 1 dhe neni 73, pika 1, germa b) dhe dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holding International B.V. dhe United World Technologies B.V.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 995, Datë 05. 07. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AMB CONSTRUCTION SHPK NGA SHOQËRITË AGNA SHA, INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë vlerësimit të shkresës nr. 263 datë 05.05.2023 të gazetarit Armand Kullau, konstatoi se ndërmjet z. Marin Gjonaj dhe shoqërive AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK, më datë 15.04.2021, është nënshkruar dokumenti “Kontratë shitblerje (Kuote)”, e cila ka sjellë si pasojë, ndryshimin e kontrollit të shoqërisë AMB Construction SHPK.

Në zbatim të nenit 10, 12 dhe 53 të ligjit nr. 9121/2003, ju kërkua shoqërisë AMB Construction SHPK të depozitonte dokumentacionin e përcaktuar në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve.

Referuar dokumentit “Kontratë shitblerje (Kuote)”, të nënshkruar më datë 15.04.2021, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse:

Blerësi 1: AGNA SHA, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import eksport të mallrave industriale e ushqimore, materiale ndërtimi, prodhime bujqësore e blegtorale, prodhim e shitje pije alkoolike, pjesë këmbimi, tregtimin e tyre me shumicë dhe pakicë si dhe transport mallrash dhe udhëtarësh, etj.

Blerësi 2: TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: marrja përsipër e hartimit të projekteve të ndryshme ndërtimore të fushave të ndryshme dhe të realizimit të ndërtimit në përgjithësi; ndërtim në fushën e turizmit, të infrastrukturës, qendrave të biznesit, aktivitet në blerjen, shitjen, qiradhënien e zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme, etj.

Blerësi 3: Info-Telecom SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ofrimin e shërbimeve dhe çdo aktivitet në fushën e telekomunikacionit të përcaktuara në legjislacionin përkatës shqiptar. Përfaqësimi i shoqërive të ndryshme të huaja në territorin shqiptar. Aktivitete në blerjen, shitjen, qiradhënien e zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme, etj.

Pala shitëse: Z. Marin Gjonaj, është person fizik dhe ortak i vetëm i shoqërisë target AMB Construction SHPK, i cili zotëron 100% të kuotave të kësaj shoqërie.

Z.Marín Gjonaj, zotëron indirekt 100% dhe aksionet e shoqërisë Info-Telecom SHPK, nëpërmjet shoqërisë GJONAJ GROUP HOLDINGS SHPK.

Shoqëria Target: AMB Construction SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: dhënie me qira e impianteve fotovoltaike, tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, impianteve/paneleve fotovoltaike, elektroshtëpiake, elektronike, sistemeve/impianteve termike të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme për mirë menaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, të telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme të destinuara për objekte civile dhe industriale, për sektorë të ndryshëm. Tregtim i energjisë nga burime të rinovueshme. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software, etj.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë AGNA SHA (blerësi 1), TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK (blerësi 2), INFO-Telecom SHPK (blerësi 3) dhe Z.Marín Gjonaj (shitësi), është nënshkruar “Kontratë shitblerje (Kuote)”, më datë 15.04.2021.

Objekti i kësaj kontrate ishte shitja nga ana e shitësit tek blerësit 100% e kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, kapital i cili ndahet në 3 (tre) kuota.

Aktualisht shoqëria AGNA SHA, zotëron 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, duke përbërë një kuotë; shoqëria TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, të përbërë nga një kuotë dhe shoqëria INFO-Telecom SHPK, zotëron 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, të përbërë nga një kuotë.

Marrëveshja e mësipërme nuk është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës. Palët pjesëmarrëse kanë përfunduar mbylljen e marrëveshjes dhe në datë 21.04.2021, kanë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ndryshimin e kontrollit të shoqërisë.

Transaksioni ka sjellë për pasojë përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK, nga shoqëritë AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, dhe INFO-Telecom SHPK, i parashikuar në nenin 10, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Referuar pasqyrave financiare të palëve pjesëmarrëse në transaksion rezulton se plotësohet kriteri i xhiros i parashikuar në nenin 12, pika 1, germa b) e ligjit dhe ky transaksion duhet të

ishte objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Analiza e konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ndërtimeve dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni përbën një përqendrim konglomerat ku palët pjesëmarrëse në transaksion operojnë në tregje të ndryshme.

Transaksioni ka për pasojë përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, dhe INFO-Telecom SHPK.

Shoqëria AGNA SHA, vitet e fundit ka realizuar të ardhura kryesisht nga tregtia me shumicë e mallrave ushqimorë industrialë dhe duhanit të importuar dhe një pjesë të vogël nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme.

Shoqëria TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK., vitet e fundit ka realizuar të ardhura kryesisht nga ndërtimi dhe tregtia e energjisë elektrike.

INFO-Telecom SHPK, për vitin 2020 ka realizuar të ardhura kryesisht nga shitja e shërbimeve të komunikimeve elektronike brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Shoqëria AMB Construction SHPK operon kryesisht në fushën e ndërtimit të ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, ujësjellësve, mbikalime e nënkalime.

Përqendrimi nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk ka sjellë kufizim të konkurrencës në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.
- II.** Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 996, Datë 05. 07. 2023

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE AGNA SHA, INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AMB CONSTRUCTION SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i sjelljes së shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK në lidhje me mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë AMB Construction SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53-64 dhe neni 73 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm; raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”,

VËREN SE :

I. Procedura

Autoriteti Konkurrencës, gjatë vlerësimit të shkresës nr. 263 datë 05.05.2023 të gazetarit A.K. konstatoi se ndërmjet z.M.Gj. dhe shoqërive AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK, më datë 15.04.2021 është nënshkruar dokumenti “Kontratë shitblerje (Kuote)”, e cila ka sjellë si pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë AMB Construction SHPK.

Në zbatim të nenit 10, 12 dhe 53 të ligjit nr. 9121/2003, me shkresën nr.278 prot., datë 25.05.2023, “Mbi fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit”, iu kërkua shoqërisë AMB Construction SHPK, depozitimi i dokumentacionit për fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve, dokumentacion i cili u depozitua me shkresën nr.278/1 prot., i AK, datë 25.05.2023, “Përcjellja e formularit të përqendrimit dhe dokumentacionit”.

Ndërmjet shoqërisë AGNA SHA (blerësi 1), TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK (blerësi 2), Info-Telecom SHPK (blerësi 3) dhe Z.M. Gj. (shitësi), më datë 15.04.2021, ishte nënshkruar dokumenti “Kontratë shitblerje (Kuote)”.

Marrëveshja konsistonte në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, sipas ndarjes, 40% të kapitalit të zotërohet nga shoqëria AGNA SHA; 20% të kapitalit nga shoqëria TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe 40% të kapitalit nga shoqëria Info-Telecom SHPK.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë kërkon autorizim nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Bazuar në nenin 12, pika 2 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Në rastin e përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK, detyrimin për njoftim e kanë shoqëritë blerëse, AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK, dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

Për mos respektim të afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit, bazuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë për shkelje të lehtë, në masën jo më shumë se 1% e xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve, e cila në këtë rast do të ndahet mes tre shoqërive të mësipërme, në përpjesëtim me përqindjen e kuotës së kapitalit në shoqërinë target, AMB Construction SHPK.

Në vendosjen e vlerës së gjobës, Komisioni i Konkurrencës është mbështetur në ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” miratuar më VKK nr. 165 datë 14.12.2010; Rregulloren “Për Gjobat dhe Lehtësimin prej tyre” miratuar me VKK nr.120 datë 10.09.2009; vendimet e Komisionit Evropian dhe vendimet e Komisioni Shqiptar të Konkurrencës për raste të ngjashme të shqyrtuara.

Neni 18 i ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, specifikon se: organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh: a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë; c) rëndësinë e kundërvajtjes; ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

Për të vlerësuar rëndësinë/gravitetin e shkeljen Komisioni i Konkurrencës ka marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Njoftimi është bërë me iniciativën e Autoritetit të Konkurrencës,
- Procedura është kryer pasi ka kaluar 6 muaj nga parashikimi i nenit 12, pika 2 e Ligjit,
- Përqendrimi vlerësohet si përqendrim konglomerat,
- Shoqëritë nuk rezultojnë të kenë kryer shkelje të mëparshme në kundërshtim me ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Në zbatim të nenit 15, pika 1 e ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe referuar pasqyrave financiare të vitit 2020 të shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK rezulton se xhiroja e shoqërive blerëse është në vlerën rreth [...] lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK vendosjen e gjobës mbi.
- i. shoqërinë AGNA SHA, në masën [...] lekë,
 - ii. shoqërinë INFO-Telecom SHPK, në masën [...] lekë,
 - iii. shoqërinë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK SHPK, në masën [...] lekë,
- II.** Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 997, Datë 05. 07. 2023

“MBIAUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË KUOTAVE TË SHOQËRISË PARQUE EÓLICO LITUECHE SPA NGA SHOQËRIA EMPRESA ELÉCTRICA PILMAIQUÉN S.A.”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitblerje kuotash”, Draft Paraparak, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A, është një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kilit, e angazhuar në gjenerimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike. Shoqëria zotërohet në 99.43% të kuotave nga shoqëria Statkraft Chile Inversiones Eléctricas Limitada, shoqëri e grupit Statkraft, një shoqëri lider në prodhimin e energjisë hidrike në arenën ndërkombëtare dhe asaj të rinovueshme në Europë.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V; - *Statkraft Renewables Albania SHPK*, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike

dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj, dhe - *Devoll Hydropower SHA*, shoqëri aksionare e themeluar, me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike në Luginën e Devollit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse: Plan-8 Energía Infinita Limitada, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Kilit. Plan-8 Energía Infinita Limitada zotëron 100% të kuotave të shoqërisë target, Parque Eólico Litueche SpA.

Shoqëria Target: Parque Eólico Litueche SpA, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Kilit, e krijuar posaçërisht për të implementuar projektin e një fermë ere në Kili, aktualisht në një stad zhvillimi të avancuar. Shoqëria target është aktive në tregun e zhvillimit të projekteve të gjenerimit të energjisë së rinovueshme nga burime jo-konvencionale në Kili.

Shoqëria target nuk është prezente dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Referuar dokumentacionit zyrtar të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, rezulton se: Blerësi Empresa Eléctrica Pilmaquén S.A është në proces negociimi të lidhjes së Marrëveshjes së blerjes së kuotave me shitësin Plan-8 Energía Infinita Limitada. Pritet që pas lidhjes së kësaj Marrëveshje, me përmbushjen e kushteve të mbylljes (të cilat do të përkufizohen në Marrëveshje), shitësi do të shesë të gjitha kuotat e zotëruara në kapitalin e shoqërisë target, Parque Eólico Litueche SpA.

Transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 60 pika 1 të ligjit 9121/2003, pala njoftuese ka kërkuar Autorizimin e Përqendrimit të Përkohshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët, pasi procesi i pritjes së miratimit të transaksionit nga Autoriteti i Konkurrencës shkakton vonesa, të cilat do të kishin pasoja të pariparueshme për lidhjen e kësaj marrëveshje.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të kuotave të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaquén S.A. Empresa Eléctrica Pilmaquén S.A zotërohet nga shoqëria Statkraft Chile Inversiones Eléctricas Limitada, pjesë e grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Parque Eólico Litueche SpA nuk është prezente dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri. Pas vendosjes në operim, projekti do të ketë ndikim vetëm në tregun e energjisë së Kilit.

Përqendrimi i propozuar nuk pritet të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar duket se nuk do të sjellë ndryshim dhe duket se nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Autoriteti i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e marrëveshjes së nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe të nenit 60 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.
- II.** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
- III.** Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- IV.** Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 998, Datë 05. 07. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË DREJTPËRDREJTË DHE TË TËRTHORTË TË SHOQËRISË INFOSOFT SYSTEMS SHPK NGA Z. ARMAND SHARRA.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shoqërisë Infosoft Systems SHPK nga z. Armand Sharra.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shoqërisë Infosoft Systems SHPK nga z. Armand Sharra.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi lidhur me transaksionin e përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shoqërisë Infosoft Systems SHPK nga z. Armand Sharra.

Referuar dokumentit “Kontratë shitjeje kuotash”, palët në transaksion janë:

Blerësi: z. Armand Sharra person fizik, shtetas shqiptar, i cili zotëron në mënyrë direkte 100% të kuotave në shoqërinë Tag Engineering SHPK.

Shitësi: z. Grigor Joti, person fizik, shtetas shqiptar, i cili shet të gjitha kuotat që zotëron në shoqërinë target Infosoft Systems SHPK.

Shoqëria Target: Infosoft Systems SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: a. Importim, eksportim dhe tregtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve si: hardware, software, networking dhe të gjithë periferikeve të tyre. Montim aparaturash të sipër përmendura, parametrizim, konfigurim. b. Disenjim software-i. c. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. d. Testim software.

e. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. f. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. g. Zhvillim sistemesh migrimi. h. Përmiresim/upgrade sistemesh informatike. i. Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software. j. Ndërtim, zhvillim dhe operim i qendrave të të dhënave. k. Import - eksport të produkteve/shërbimeve të përmendura në këtë nen të cilat janë të klasifikuara me përdorim të dyfishtë, etj.

Shoqëria target Infosoft Systems SHPK, ushtron aktivitetin në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

II. Transaksioni

Ndërmjet z. Armand Sharra (blerësi), dhe z. Grigor Joti (shitësi) është nënshkruar “Kontratë shitjeje kuotash”, në lidhje me shitjen e kuotave në shoqërinë Infosoft Systems SHPK, (target) më datë 09 maj 2023.

Objekt i kësaj kontrate është shitja nga shitësi tek blerësi i kuotës të zotëruar në shoqëri, që përbën 36.663% të kuotave totale të shoqërisë.

Struktura e pronësisë së shoqërisë Infosoft Systems SHPK, me nënshkrimin e “Kontratës për shitblerjen e kuotave” datë 09.05.2023 rezulton të jetë: - Ortaku individ z. Armand Sharra, do të zotërojë në kapitalin e shoqërisë Infosoft Systems SHPK 36.663% të kuotave të saj; -Tag Engineering SHPK, do të zotërojë në kapitalin e shoqërisë Infosoft Systems SHPK 30% të kuotave të saj;- Ortaku individ z. Bledar Dhima, do të zotërojë në kapitalin e shoqërisë Infosoft Systems SHPK 33,337% të kuotave të saj.

Shoqëria Tag Engineering SHPK zotërohet 100% nga z. Armand Sharra, fakt i cili i jep të drejtën z. Armand Sharra të përfitojë direkt dhe indirekt (36.663% + 30%) 66.663% të kapitalit në shoqërinë Infosoft Systems SHPK, duke zotëruar shumicën e kuotave në shoqërinë target.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit, do të konsiderohet tregu i shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu global i teknologjisë së informacionit segmentohet sipas:

- Llojit: Shërbime IT, pajisje kompjuterike (hardware), produkte të komunikimit dhe software;
- Madhësisë së organizatës: ndërmarrje të mëdha, të mesme dhe të vogla;
- Industria e përdoruesit fundor: Shërbime financiare; shitjes me pakicë dhe shumicë, prodhimit; kujdesit shëndetësor dhe përdoruesve të tjerë përfundimtar.

Sipas vlerësimeve të brendshme të shoqërisë, shoqëria Infosoft Systems SHPK mbulon rreth:

- xx% të ofrimit të shërbimeve të specializuara teknologjike për kompanitë në Shqipëri dhe rajon. Në fushën e TIK, këto shërbime variojnë nga ofrimi i këshillave të ekspertëve deri te aktivitetet praktike si implementimi i software në qendrën e të dhënave të klientit ose në cloud computing (reja kompjuterike);
- xx% të tregut të implementimit të software për organizata të vogla, të mesme dhe të mëdha, spitale, banka dhe industri të tjera në Shqipëri;
- xx% të nevojave të klientëve për servera dhe ruajtjen e të dhënave;

- xx% të kërkesave për pajisje të rrjeteve dhe shërbimeve (network).

Shoqëria Tag Engineering SHPK ka si objekt aktiviteti: Pjesëmarrje në shoqëri të tjera si dhe në organe drejtuese të këtyre shoqërive; konsulencë në menaxhimin dhe administrimin e biznesit; menaxhimi i shoqërive tregtare; veprimtari të blerjes, shitjes dhe qiradhënies së pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme; konsulencë juridike dhe përfaqësim në institucione shtetërore në fushën civile, penale, tregtare dhe administrative; shërbime dhe zhvillime të programeve të teknologjisë informative; konsulencë financiare, kontabiliteti, auditimi dhe tatimore; kërkime tregu dhe shërbime prokurimi etj.

Referuar raportit financiar të audituar të vitit 2022, shoqëria Tag Engineering SHPK ka ushtruar aktivitet në fushën e investimeve në kapital, të qiradhënies dhe huadhënies nga ku rezulton se të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit përbëhen nga:

- [...],
- [...]

Për sa më sipër, shoqëria Tag Engineering SHPK nuk ushtron të njëjtin aktivitet ekonomik me shoqërinë Target.

Përftimi i kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shoqërisë Infosoft Systems SHPK nga z. Armand Sharra nuk do të sjellë mbivendosje horizontale të aktivitetit ekonomik të shoqërisë Infosoft Systems SHPK dhe Tag Engineering SHPK, pasi shoqëritë operojnë në tregje të ndryshme.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim në tregun shqiptar

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shoqërisë Infosoft Systems SHPK nga z. Armand Sharra.
- II.** Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 999, Datë 05.07. 2023

“PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM NË KRYERJEN E DETYRAVE FUNKSIONALE TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Zëvendësimi i përkohshëm në kryerjen e detyrave funksionale të Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Diana Dervishi.

Baza Ligjore: Nenet 24, germa d, nenet 27, pika 1 dhe Urdhrit nr. 20 datë 27 qershor 2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”

Komisioni i Konkurrencës, pas vlerësimit të procedurave të deritanishme në lidhje me ecurinë e procedimit disiplinor ndaj znj. Diana Dervishi dhe sigurimit të mbarëvajtjes administrative në Autoritetin e Konkurrencës,

VËREN SE :

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datën 27 qershor 2023 shqyrtoi rendin e ditës “Disa problematika të brendshme të Autoritetit të Konkurrencës” dhe konstatoi se për znj. Diana Dervishi duhet të fillojë procedimi disiplinor.

Në zbatim të nenit 57, pika 2 germa a); nenit 59, pika 6 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 115 datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin , përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor”, Komisioni Disiplinor i ngritur me Urdhrit nr. 20 datë 27 qershor 2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, vendosi pezullimin e nëpunësit civil, znj Diana Dervishi, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenet 27, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Zëvendësimin e përkohshëm në kryerjen e detyrave funksionale të Sekretarit të Përgjithshëm të znj. Diana Dervishi nga znj. Dhurata Skënderi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1000, Datë 17. 07.2023

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE RAIMONDO G.P SHPK DHE LI.BO-ALBANIA BRANCH SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17. 07.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e procedurës së hetimit paraparak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, mbi Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë Li.BO-Albania Branch SHPK me nr.1250 prot., datë 31.05.2023 dhe TrakMar SHPK, me nr.1257 prot., datë 01.06.2023” dhe fillimin e procedurës së hetimit administrativ nga Autoriteti i Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) nëpërmjet shkresës nr. 1257/4 prot., datë 04.07.2023 (protokolluar pranë AK me nr. 373 prot., datë 06.07.2023) ka depozituar Vendimin nr. 555/2023 prot., datë 04.07.2023, “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë Li.BO-Albania Branch SHPK me nr.1250 prot., datë 31.05.2023 dhe Trakmar SHPK, me nr.1257 prot., datë 01.06.2023”.
2. KPP, nëpërmjet vendimit nr. 555/2023 ka vendosur:
 - a) Të pezullojë shqyrtimin administrativ të operatorëve ekonomikë LI.BO-Albania Branch SHPK me nr. 1250 prot., datë 31.05.2023 dhe TrakMar SHPK me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023 për procedurën e prokurimit “objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA.
 - b) T’i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë KPP në përfundim të hetimit mbi

rezultatet e tij.

3. Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga KPP, nëpërmjet vendimit nr. 555/2023, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet LI.BO-Albania Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA, vihet re se:
 - Operatori Raimondo G.P SHPK dhe operatori LI.BO-Albania Branch SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.
 - Gjithashtu sipas të dhënave në ekstrakt, të cilat njoftohen vullnetarisht rezulton se adresa e emailit dhe numri i telefonit fiks është i njëjtë për të dyja ndërmarrjet.
 - Ofertat e këtyre dy ofertuesve kanë një diferencë të vogël ndërmjet tyre;
 -
4. Të dy operatorët nuk kanë plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimit publik” dhe Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
5. Sa më sipër ngrihen dyshime të arsyeshme se ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të sinqertë.
6. Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimit “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, kjo sjellje hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të pajisjeve, instrumenteve, veglave elektrike dhe dixhitale të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA.
7. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit të pajisjeve, instrumenteve, veglave elektrike dhe dixhitale të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA, ka elementë të një sjelljeje antikonkurrese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK.
- II. Hetimi paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga 26.09.2022 deri në 17.07.2023
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1001, Datë 17.07. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË KUOTAVE TË SHOQËRIVE GGE IRELAND LIMITED DHE EMP ENERGY LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IRELAND LIMITED”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17 . 07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit, raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive GGE Ireland Limited dhe shoqërisë EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi transaksionin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited, nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitblerjen e kuotave”, Draft Paraparak, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft Ireland Limited është një shoqëri private, e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është i përqendruar në gjenerimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike.

Statkraft Ireland Limited është shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS, shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë dhe aktori më i madh i hidroenergjisë së rinovueshme në Evropë.

Statkraft AS është shoqëria mëmë e disa filialeve të Statkraft Group dhe zotërohet tërësisht nga Statkraft FS.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA është një shoqëri aksionare me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësiteve prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 Mw në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Garantori: Statkraft AS është një kompani hidroenergjetike, në pronësi të plotë të shtetit norvegjez. Statkraft Group është prodhuesi më i madh në Evropë i energjisë së rinovueshme, si dhe prodhuesi më i madh i energjisë në Norvegji dhe i tretë në rajonin nordik.

Shoqëritë Target:

Target 1: GGE Ireland Limited është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës, me objekt aktiviteti zhvillimin e aseteve të prodhimit të energjisë nga era, dielli dhe ruajtja e energjisë nëpërmjet baterive.

Target 2: EMP Energy Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës, me objekt aktiviteti zhvillimin e aseteve të prodhimit të energjisë nga era, dielli dhe ruajtja e energjisë nëpërmjet baterive.

Shoqëritë target nuk janë prezente dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

Pala Shitëse:

Shitësi 1: Galileo Green Energy GmbH është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Zvicrës.

Shitësi 2: Wind Power Invest A/S është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Danimarkës.

Shitësi 3: Emerging Markets Power (Holdings) Limited është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Anglisë.

Shitësi 4: GGE Ireland Limited është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës.

II. Përqendrimi

Referuar Draftit Paraprak “Marrëveshje për shitblerjen e kuotave” rezulton se:

-Blerësit Statkraft Ireland Limited do të transferohen rregullisht kuotat e zotëruara në shoqërinë GGE Ireland Limited, së bashku me çertifikatat e kuotave, nga shitësi Galileo Green Energy GmbH, si pronar i vetëm ligjor i kapitalit në shoqërinë target 1.

- Blerësit Statkraft Ireland Limited do të transferohen rregullisht kuotat e zotëruara në shoqërinë EMP Energy Limited, së bashku me çertifikatat e kuotave nga shitësit, (i) GGE Ireland Limited, i cili zotëron 50% të kapitalit të regjistruar, (ii) Emerging Markets Power (Holdings) Limited, i cili zotëron 25% të kapitalit të regjistruar dhe (iii) Wind Power Invest A/S, i cili zotëron 25% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë target.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Pala njoftuese na bën me dije se procesi i pritjes së miratimit të transaksionit të propozuar nga Autoriteti i Konkurrencës shkakton vonesa për këtë transaksion dhe palët do të kishin pasoja të pariparueshme për shkak se marrëveshja nuk do të arrijë të lidhet. Në zbatim të nenit 60 pika 1 të ligjit 9121/2003, pala njoftuese ka kërkuar Autorizimin e Përqendrimit të Përkohshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët.

Përqendrimi i njoftuar pritet të mos krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Autoriteti i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e marrëveshjes së nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.
- II.** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
- III.** Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1004, Datë 20. 07. 2023

“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI NË PËRLLOGARITJE TË GJOBËS SË VENDOSUR SHOQËRISË TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK ME VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 996 DATË 05.07.2023 “PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE AGNA SHA, INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AMB CONSTRUCTION SHPK”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20. 07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Për një korrigjim gabimi në përlogaritje të gjobës së vendosur shoqërisë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 996 datë 05.07.2023 “PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE AGNA SHA, INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AMB CONSTRUCTION SHPK”.

Baza Ligjore:

Neni 2, neni 24, germa d, neni 73 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe neni 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm (i komanduar) “Mbi vlerësimin e gjobës së shoqërisë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”

VËREN SE :

Procedura

Komisioni i Konkurrencës në vendimin nr. 996 datë 05.07.2023 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”, vendosi që për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK

dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK vendosjen e gjobës mbi.

- a) shoqërinë AGNA SHA, në masën [...] lekë,
- b) shoqërinë INFO-Telecom SHPK, në masën [...] lekë,
- c) shoqërinë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK SHPK, në masën [...] lekë,

Gjatë vlerësimit të transaksionit, Komisioni i Konkurrencës evidentoi faktin që mbështetur në nenin 53, germa b) të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, *kanë detyrimin për njoftim ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera*; dhe në rastin e përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK, detyrimin për njoftim e kanë patur shoqëritë blerëse, AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK, dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

Për mos respektim të afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit, bazuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121/2003, *Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë për shkelje të lehtë, në masën jo më shumë se 1% e xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve.*

Baza e llogaritjes së gjobës vlerësohet sipas parashikimit të nenit 15 të ligjit nr. 9121/2003, *pas zbritjes së tatimeve, taksave dhe tarifave të tjera që lidhen drejtpërdrejtë me xhiron e ndërmarrjeve.*

Mbështetur në pasqyrat financiare të tre shoqërive blerëse, xhiroja e tre shoqërive, së bashku, për efekt vlerësimit të gjobës është [...] lekë dhe vlera maksimale e gjobës sipas nenit 73 të ligjit do të ishte [...] lekë (1% e xhiros).

Me vendimin nr. 996 datë 05.07.2023, Komisioni i Konkurrencës vendosi të gjobisë tre ndërmarrjet në vlerën totale [...] lekë, që përbën xx % e xhiros së tre shoqërive së bashku.

Në këtë vendim, Komisioni arsyetoi që gjoba “...të ndahet mes tre shoqërive të mësipërme, në përpjesëtim me përqindjen e kuotës së kapitalit në shoqërinë target, AMB Construction SHPK.”, duke u ndarë respektivisht në masën [...] lekë për shoqërinë AGNA SHA, në masën [...] lekë për shoqërinë INFO-Telecom SHPK dhe në masën [...] lekë për shoqërinë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

Nga verifikimi i të dhënave financiare të shoqërive, u konstatua se xhiroja nga aktiviteti ekonomik i shoqërisë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, sipas nenit 15 të ligjit nr. 9121/2003, është në vlerën [...] lekë dhe masa e gjobës përbën xx % të xhiros, duke tejkaluar masën e përqindjes sipas parashikimeve të nenit 73 të ligjit nr. 9121/2003.

Për sa më sipër dhe mbështetur në nenin 112 “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktet administrative” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Konkurrencës gjykon se është në kushtet që organi publik, në çdo kohë, mund të korrigjojë gabimet në përlllogaritje, të një akti administrativ, dhe mbështetur në nenin 73, pika 1 e ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përlllogariti dhe korrigjoi masën e gjobës ndaj shoqërisë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, duke e vendosur brenda kufijve të përcaktimit ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr.

9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenin 112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- I.** Të ndryshojë pikën 1, germa c) të vendimit nr. 996 datë 05.07.2023 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”, si më poshtë:
 - a. shoqërinë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK SHPK, në masën [...] lekë,
- II.** Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1005 , Datë 28. 07. 2023

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË AIR BP ALBANIA SHA PËR DEKLARIM TË TË DHËNAVE TË PAPLOTA DHE TË PASAKTA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28. 07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Shqyrtimi i sjelljes së shoqërisë United World Technologies B.V. për njoftimin jashtë afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V. dhe depozitimin e të dhënave të pasakta nga shoqëria AIR BP ALBANIA SHA

Baza Ligjore:

Neni 2, neni 12, neni 24, germa d, neni 55 dhe neni 73, pika 1, germa b) e dh) i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA SHA për deklarim të të dhënave të pasakta.” dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.

VËREN SE :

I. Procedura

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 629 prot. i AK, datë 24.10.2022 “Kërkesë”, është njoftuar nga shoqëria AIR BP ALBANIA SHA në lidhje me përfutimin e kontrollit të përbashkët të saj nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.

Me shkresën nr. 629/1, prot., i AK, datë 01.11.2022 “Kthim përgjigje”, Autoriteti ka sqaruar shoqërinë AIR BP ALBANIA SHA, se transaksioni i përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V., mund të përbente një përqendrim, i cili do të ishte objekt vlerësimi nga ky i fundit.

Shoqëria AIR BP ALBANIA SHA me shkresën nr. 629/2, prot. i AK, datë 17.11.2022 “Dërgim i Formularit të thjeshtuar të përqendrimeve”, ka dorëzuar Formularin e thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit me disa seksione të padetajuara.

Në zbatim të nenit 55 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2023, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 629/3, prot. i AK, datë 06.12.2022 “Kërkesë për Informacion”, ka kërkuar plotësim të dokumentacionit dhe

konkretisht informacion lidhur me: a) Ekstrakt/Statut të shoqërisë BP Holdings International B.V.; United World Technologies B.V.; b) Pasqyrat financiare të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA, BP Holdings International B.V., viti 2021; c) Marrëveshja e shitblerjes ndërmjet BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V. (të gjitha sa më sipër në shqip, origjinale ose e njehsuar me origjinalin); d) Plotësim i detajuar i seksioneve të Formularit të thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit.

Në përgjigje të Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 34, prot. i AK, datë 16.01.2023 “Kthim përgjigje shkresës Nr. 629/3 Prot., datë 06.12.2022”, shoqëria AIR BP ALBANIA SHA ka depozituar dokumentacion si vijon: Pasqyrat financiare të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA dhe shoqërisë BP Holdings International B.V. viti 2020; Marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve (mungon data e lidhjes së kontratës nga palët pjesëmarrëse), (të gjitha sa më sipër në formën e kërkuar ligjore) dhe Formularin e thjeshtuar të njoftimit të përqendrimeve me plotësime shtesë.

Me shkresën nr. 34/1, prot., i AK, datë 23.02.2023 “Kërkesë për Informacion” është kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës dokumentacion plotësues, në lidhje me: a) Ekstrakt/statut të shoqërisë BP Holdings International B.V., United World Technologies B.V., b) Statut të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA; c) Pasqyrat financiare të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA, BP Holdings International B.V. viti 2021; d) Marrëveshjen e shitblerjes ndërmjet BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V. me datën përkatëse të lidhjes së saj.

Me shkresën nr. 34/2, prot. i AK, datë 06.04.2023 “Kthim përgjigje shkresës suaj Nr. 34/1 Prot., datë 29.02.2023, dërgim dokumentacioni” shoqëria AIR BP ALBANIA SHA ka dorëzuar dokumentacion shtesë si vijon: Ekstraktin e shoqërisë BP Holdings International B.V.; Statutin e shoqërisë BP Holdings International B.V.; Ekstraktin e shoqërisë United World Technologies B.V.; Statutin e shoqërisë United World Technologies B.V.; Statutin e shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA; Pasqyrat financiare të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA viti 2021, Pasqyrat financiare të shoqërisë BP Holdings International B.V. viti 2021 (i pa plotësuar).

Pas vlerësimit të dokumentacionit të depozituar, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën 34/3, prot., i AK, datë 12.04.2023 “Kërkesë për informacion”, ka kërkuar saktësimin e datës së lidhjes së kontratës ndërmjet BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.

Me shkresën nr. 34/4, prot. i AK, datë 05.05.2023 “Kthim përgjigje shkresës suaj Nr. 34/3 Prot., datë 12.04.2023” shoqëria AIR BP ALBANIA SHA ka pretenduar se marrëveshja e shitjes së aksioneve ka përfunduar me nënshkrimin e saj nga palët më datë 30.09.2022. Gjithashtu shoqëria ka depozituar mandatin e pagesës së detyrimeve, duke pohuar se lidhja e marrëveshjes së aksionareve dhe fillimi i efekteve të saj, pra zotërimi i aksioneve nga blerësi, do të konsiderohet kryerja e pagesës më datë 21.10.2022.

Referuar dokumentacionit të depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, u administrua Vendimi i Aksionarit të vetëm të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA, datë **22 korrik 2022**, në të cilin është miratuar shitja e 30.000 aksioneve dhe kalimi i pronësisë së këtyre aksioneve në pronësi të ortakut të vetëm të shoqërisë BP Holdings International B.V., që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA, tek United World Technologies B.V.

Bazuar në Statutin e AIR BP ALBANIA SHA, neni 10 “Transferimi i Aksioneve” përcaktohet se: “Në çdo rast, transferimi i aksioneve ndaj palëve të treta, do t’i nënshtrohet sipas rastit, miratimit paraprak me unanimitet nga Asambleja e Aksionarëve ose ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga aksionari tjetër, si dhe do të realizohet në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes së Aksionarëve të **datës 22 korrik 2022** dhe çdo ndryshim të mundshëm, vijues të kësaj të fundit”.

Gjithashtu në nenin 12.2 të Statutit të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA, citohet se: “Kompetencat e organeve të shoqërisë janë të përcaktuara në legjislacionin tregtar në fuqi, në këtë Statut, si dhe në Marrëveshjen e Aksionarëve të **datës 22 korrik 2022** dhe çdo ndryshim të mundshëm vijues të kësaj të fundit.

Të gjitha këto akte i referohen datës 22 korrik 2022 si datë të lidhje së marrëveshjes së aksionarëve. Edhe pse u kërkua në mënyre konsistente nga Autoriteti i Konkurrencës saktësimi i datës së lidhjes së marrëveshjes së aksionareve, pala njoftuese nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë datën e marrëveshjes, por i është referuar datës së hyrjes në fuqi, apo datës së kryerjes së pagesave.

Marrëveshja e aksionarëve ka për pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë target AIR BP ALBANIA SHA e cila do të zotërohet në mënyrë të barabarte nga shoqëritë United World Technologies B.V. dhe BP Holdings International B.V.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni përbënte një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 994, datë 05.07.2023, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World technologies B.V.”, vendosi autorizimin e tij.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të ligjit.

Bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrjet pjesëmarrëse, ato që bëjnë pjesë në një grup sipas nenit 16 të ligjit dhe ndërmarrjet që shesin një pjesëmarrje ose pjesë ndërmarrjeje, edhe nëse atyre u është dërguar vërtetimi që konfirmon marrjen e njoftimit të plotë, detyrohen t’i sigurojnë Autoritetit, brenda një afati të caktuar prej tij, të dhënat dhe dokumentet shtesë, që janë me interes për vlerësimin e përqendrimit.

Transaksioni i përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World technologies B.V., është njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës nga shoqëria AIR BP ALBANIA SHA, si shoqëri target dhe shoqëri pjesëmarrëse në transaksion.

Gjatë ndjekjes së procedurave, Autoriteti i Konkurrencës konstatoi se ndodhemi përpara dy shkeljeve administrative:

- i. *Pala njoftuese nuk ka deklaruar në mënyrë të plotë dhe të saktë datën e lidhjes së marrëveshjes në përgjigje të kërkesës së Autoritetit, në zbatim të nenit 55 të ligjit.*

Në kuptim të nenit 55 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar dhe vlerësuar dokumentacionin e dosjes së depozituar nga shoqëria AIR BP ALBANIA SHA nga ku u konstatua se shoqëria AIR BP ALBANIA SHA nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë datën e lidhjes së marrëveshjes

Bazuar në Vendimit e Aksionarit të vetëm dhe Statutin e shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA konstatohet se data e lidhjes së marrëveshjes, e cila solli si pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë AIR BP Albania SHPK, është data 22 korrik 2022.

Për sa më sipër, shoqëria AIR BP ALBANIA SHA ka kryer shkelje administrative, pasi deklarimi i të dhënave të pasakta në zbatim të nenit 55, përbën një shkelje të lehtë të ligjit nr. 9121/2003 dhe bazuar zbatim të nenit 73, pika 1 germa b) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë në masën jo më shumë se 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve nëse japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në njoftimet, sipas neneve 12 e 49 të këtij ligji, ose të dhëna dhe dokumente plotësuese të pasakta e të paplota, sipas nenit 55 të këtij ligji.

Referuar pasqyrave financiare të vitit 2021 të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA dhe në zbatim të nenit 15, pika 1 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vlera e xhiros mbi të cilën

Ilogaritet gjoba është [...] lekë.

Në vendosjen e masës së gjobës, Komisioni i Konkurrencës është mbështetur në raste të ngjashme të sanksionimit me gjobë në tregun e karburanteve (rasti i përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA).

Sipas pasqyrave financiare të vitit 2021, rezulton se shoqëria AIR BP ALBANIA SHA nuk është në vështirësi financiare.

ii. Njoftimi i përqendrimit nuk është depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda afatit 30 ditor, duke mos plotësuar kriteret e nenit 12, pika 2, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Referuar datës 22 korrik 2022, si data e lidhjes së marrëveshjes së aksionarëve, konstatohet fakti që transaksioni është njoftuar jashtë afatit 30 ditor nga lidhja e marrëveshjes, i parashikuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Referuar nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftimin e një përqendrimi: b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera; dhe në këtë procedurë ky detyrim i lind shoqërisë United World Technologies B.V.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të dosjes rezulton se shoqëria United World Technologies B.V. është krijuar në vitin 2022 dhe për pasojë nuk ka realizuar xhiro për vitin 2021.

Me shkresën nr 34/11 prot., datë 10.07.2023 “Kërkesë për informacion”, Autoriteti i ka kërkuar shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA, të depozitojë pasqyrat financiare për vitin 2021 të shoqërisë [...], e cila kontrollon shoqërinë United World Technologies B.V. Nga dokumentacioni i depozituar vlerësohet se shoqëria [...] është themeluar në datë 24.05.2022 dhe vepron si një fondacion.

Për sa më sipër, konstatohet se si pala blerëse edhe shoqëria mëmë e saj nuk kanë realizuar xhiro për vitin 2021.

Për këto arsye, sanksionimi i palës blerëse për mosrespektim të nenit 12 të ligjit, sipas nenit 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, është objektivist i pa mundur.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 73, pika 1 germa b) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Për depozitim të të dhënave të paplota dhe të pasakta në kuptim të nenit 55 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të gjobisë shoqërinë AIR BP ALBANIA SHA në masën [...] lekë.
- II.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
- III.** Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1006 , Datë 28.07. 2023

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE EÓLICA CQN UNO SPA DHE EÓLICA CQN DOS SPA NGA SHOQËRIA EMPRESA ELÉCTRICA PILMAIQUÉN S.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.07. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar mbi përfutimin e kontrollit të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi se shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A synonte të blejë kuotat e shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr.991, datë 08.06.2023, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm, të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.”, vendosi:

- I. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.
- II. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
- III. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitohet pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me shkresën nr. 302/7 datë 18.07.2023 “Njoftim përqendrimi përfundimtar dhe kërkesë për autorizim të përqendrimit”, jemi njoftuar mbi nënshkrimin e marrëveshjes së blerjes së aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Referuar “Marrëveshjeve për Blerjen e Aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A. është një shoqëri aksionare me kohëzgjatje të përhershme, e organizuar sipas ligjeve të Kilit, e angazhuar në prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë hidroelektrike.

Blerësi zotërohet 99.43% nga shoqëria Statkraft Chile Inversiones Eléctricas Limitada, shoqëri e grupit Statkraft, një shoqëri lider në prodhimin e energjisë hidrike në arenën ndërkombëtare dhe asaj të rinovueshme në Europë.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në datë 25.07.2018, me objekt: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA, shoqëri aksionare e themeluar më datë 17.12.2008, me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Garantuesi i Blerësit: Statkraft Chile Inversiones Eléctrica Limitada është pjesë e Statkraft.

Pala shitëse: Inversiones Bosquemar SpA është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Kilit.

Garantuesi i Shitësit: Inversiones Young Limitada është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kilit.

Shoqëria Target 1: Eólica CQN Uno SpA është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Kilit dhe është e angazhuar në zhvillimin e projekteve të energjisë përkatësisht nga era. Qëllimi i shoqërisë është të prodhojë, transportojë, shpërndajë, furnizojë, blejë dhe shesë energji elektrike, etj. Eólica CQN Uno SpA zotërohet 100% nga shoqëria Inversiones Bosquemar SpA.

Shoqëria Target 2: Eólica CQN Dos SpA është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Kilit dhe është e angazhuar në zhvillimin e projekteve të energjisë përkatësisht nga era. Qëllimi i shoqërisë është të prodhojë, transportojë, shpërndajë, furnizojë, blejë dhe shesë energji elektrike, etj. Eólica CQN Dos SpA zotërohet 100% nga shoqëria Inversiones Bosquemar SpA.

Shoqëritë target nuk janë prezente dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri

II. Përqendrimi

Më datë 27.06.2023, janë lidhur 2 (dy) “Marrëveshje për Blerje të Aksioneve”, të shoqërive target Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA, ndërmjet blerësit Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A, garantuesit të blerësit Statkraft Chile Inversiones Eléctrica Limitada, shitësit Inversiones Bosquemar SpA dhe garantuesit të shitësit Inversiones Young Limitada.

Referuar “Marrëveshjes për Blerje e Aksioneve” të shoqërisë Eólica CQN Uno SpA, shitësi Inversiones Bosquemar SpA, zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë target, e cila nga ana tjetër është pronare e projektit Eólico El Sauzal.

Në përputhje me kushtet dhe afatet e detajuara në këtë marrëveshje, shoqëria Inversiones Bosquemar SpA, shet tek blerësi 1.000 aksionet e shoqërisë Eólica CQN Uno SpA.

Në “Marrëveshjen për Blerje e Aksioneve” të shoqërisë Eólica CQN Dos SpA, shitësi Inversiones Bosquemar SpA, zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë target, e cila nga ana tjetër është pronare e projektit Eólico Cauquenes Dos ose “El Parrón”.

Në përputhje me kushtet dhe afatet e detajuara në këtë marrëveshje, shoqëria Inversiones Bosquemar SpA, shet tek blerësi 1.000 aksionet e shoqërisë Eólica CQN Dos SpA.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëritë Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA (target), kanë në pronësi dy projekte të fermave të erës (Cauquenes I dhe Cauquenes II) dhe janë aktive në tregun e zhvillimit të projekteve të gjenerimit të energjise së rinovueshme nga burime jo-konvecionale në Kili.

Shoqëritë target nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri. Pas vendosjes në operim, projektet do të kenë ndikim vetëm në tregun e energjisë së Kilit.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1007 , Datë 29. 08. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË CIRCOR INTERNATIONAL, INC. NGA KKR & CO, INC. NËPËRMJET SHOQËRISË CUBE BIDCO, INC”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 08. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të shoqërisë CIRCOR International, Inc. nga KKR & Co, Inc. nëpërmjet shoqërisë Cube BidCo, Inc.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të shoqërisë CIRCOR International, Inc. nga KKR & Co, Inc. nëpërmjet shoqërisë Cube BidCo, Inc.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfhtimin e kontrollit të shoqërisë CIRCOR International, Inc. nga KKR & Co, Inc nëpërmjet shoqërisë Cube BidCo, Inc.

Referuar “Marrëveshjes dhe Planit të Bashkimit”, datë 05 qershor 2023, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala Blerëse: Cube BidCo, Inc. është një korporatë, e themeluar për një qëllim të caktuar (SPV), në shtetin e Delaware, e cila zotërohet plotësisht, në mënyrë indirekte, nga shoqëri fonde investimesh, instrumente dhe/ose llogarive të kontrolluara dhe administruara nga shoqëria KKR & Co, Inc.

KKR & Co, Inc. është një shoqëri investimesh globale, e cila merret me administrimin e aseteve alternative, si dhe ofron zgjidhje në tregun e kapitaleve dhe sigurimeve.

Cube BidCo, Inc. zotëron plotësisht shoqërinë Cube Merger Sub, Inc., korporatë në shtetin e Delaware, e themeluar posaçërisht dhe vetëm për qëllime të këtij transaksioni, e cila nuk ka kryer asnjë aktivitet biznesi.

Shoqëria Target: CIRCOR International, Inc. është një shoqëri e listuar me ofertë publike, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të shtetit të Delaware, e cila projektton, prodhon dhe shet produkte dhe nën-sisteme teknologjike të dalluara për tregjet industriale, ajrore dhe mbrojtjes. Strategjia e shoqërisë është të rritet përmes zhvillimit të produkteve inovative dhe tregjeve që janë në rritje si hidrogjeni, mjekësia dhe hapësira.

Target operon në 18 qendra të rëndësishme prodhimi të vendosura në Amerikën Veriore, Evropën Perëndimore, Marok, Kinë dhe Indi.

Tre aksionarët më të mëdhenj të CIRCOR International, Inc. deri në datë 10 mars 2023 kanë qenë, shoqëria BlackRock Inc.; T Rowe Price Investment Management Inc. dhe Gabelli Entities.

Si pala blerëse, ashtu edhe shoqëria target nuk kanë shoqëri të kontrolluara, të regjistruara në Shqipëri, por gjenerojnë xhiro nëpërmjet shitjeve indirekte, që kryejnë shoqëritë e kontrolluara prej tyre.

II. Përqendrimi

Më datë 05 qershor 2023, shoqëritë Cube BidCo, Inc., Cube Merger Sub, Inc. dhe CIRCOR International, Inc. kanë lidhur dokumentin “Marrëveshja dhe Plani i Bashkimit”.

Referuar Marrëveshjes dhe Planit të Bashkimit, si fillim shoqëria Cube Merger Sub, Inc. do të bashkohet me dhe në shoqërinë CIRCOR International, Inc. Si rezultat i bashkimit, ekzistenca si një degë më vete e shoqërisë Cube Merger Sub, Inc. do të shuhet dhe shoqëria CIRCOR International, Inc. do të vazhdojë të ekzistojë si Korporata e Krijuar nga Bashkimi dhe si degë e zotëruar plotësisht nga Cube BidCo, Inc.

Korporata e Krijuar nga Bashkimi do të mbajë emrin CIRCOR International, Inc.

I gjithë kapitali i emtuar i shoqërisë Cube Merger Sub, Inc. në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje do të jetë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të shoqërisë Cube BidCo, Inc.

Kapitali aksionar i shoqërisë CIRCOR International, Inc., menjëherë përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, do të konvertohet në të drejtën për të marrë një shumë në para të barabartë me 56,00 dollarë/aksion dhe që nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes të gjitha këto aksione nuk do të jenë më të pashlyera dhe automatikisht do të anulohen dhe do të pushojnë së ekzistuari dhe çdo mbajtës i tyre do t'i shuhet e drejta në lidhje me to, përveç të drejtës për të marrë çmimin e pagueshëm në lidhje me këto aksione.

Me pagesën e çmimit të shitjes, blerësi Cube BidCo, Inc. do të bëhet aksioner i shoqërisë target CIRCOR International, Inc., duke zotëruar kështu 100% të aksioneve të zakonshme të shoqërisë target.

Palët kanë qëllim të përfundojnë transaksionin gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2023 dhe në përfundim të transaksionit, shoqëria Cube BidCo, Inc. do të përftojë kontrollin e shoqërisë target CIRCOR International, Inc.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i prekur nga transaksioni do të konsiderohet tregu i projektimit, prodhimit dhe shitjes së produkteve dhe nën-sistemeve teknologjike të dalluara për tregjet industriale, ajrore dhe mbrojtjes, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme

në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërisë CIRCOR International, Inc. nga KKR & Co, Inc. nëpërmjet shoqërisë Cube BidCo, Inc.

Pala blerëse, Cube Bidco, Inc. është një shoqëri e themeluar për qëllimet e transaksionit dhe zotërohet në mënyrë indirekte nga KKR.

KKR dhe Cube Bidco, Inc. nuk kanë filiale në Shqipëri, por KKR gjeneron të ardhura nëpërmjet shitjeve të realizuara nga shoqëritë me portofol të kontrolluar të fondeve të investimeve, automjeteve dhe/ose llogarive të këshilluara dhe menaxhuara nga filiale të ndryshme të KKR & Co.

CIRCOR International, Inc. nuk ka shoqëri të regjistruara në Shqipëri dhe gjeneron vetëm një xhiro minimale.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë CIRCOR International, Inc. nga KKR & Co, Inc. nëpërmjet shoqërisë Cube BidCo, Inc.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1008 , Datë 29.08. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË EFACEC POWER SOLUTIONS, SGPS S.A. NGA SHOQËRIA MUTARES SE & CO. KGAA.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.08. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Efacec Power Solutions, SGPS S.A. nga shoqëria Mutares SE & Co. KGaA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Efacec Power Solutions, SGPS S.A. nga shoqëria Mutares SE & Co. KGaA.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Efacec Power Solutions, SGPS S.A. nga shoqëria Mutares SE & Co. KGaA.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerje aksionesh” në lidhje me shitjen e 95% të kapitalit aksionar të Efacec Power Solutions, SGPS S.A., nënshkruar më datë 23 qershor 2023, palët janë:

Pala blerëse:

Mutares Holding-65 GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është ofrimi i këshillave për shoqëritë (përveç këshillave ligjore dhe tatimore), administrimin e aseteve të veta, veçanërisht blerjen, menaxhimin, mbajtjen dhe shfrytëzimin e pasurive të paluajtshme dhe pjesëmarrjen në shoqëri të çdo lloji, si dhe ofrimin e shërbimeve të tjera në lidhje me to që nuk kërkojnë licencë.

Mutares Holding-66 GmbH është një shoqëri holding, e themeluar sipas legjislacionit gjerman.

Mutares Holding-65 GmbH dhe Mutares Holding-66 GmbH zotërohen plotësisht nga shoqëria mëmë e tyre, Mutares SE & Co. KGaA.

Mutares SE & Co. KGaA (mëma e blerësve) është një shoqëri komandite e kufizuar në kuota, e listuar në bursën e Frankfurtit, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: blerjen, mbajtjen, administrimin, shitjen dhe shfrytëzimin e pasurive të paluajtshme dhe pjesëmarrjet në shoqëri; ofrimin e shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e lidhura dhe të tjera (me përjashtim të konsulencës ligjore dhe tatimore); menaxhimin e asetëve të veta; ofrimin e shërbimeve të tjera që nuk kërkojnë licencë, në lidhje me aktivitetet e sipërpërmendura.

Portofoli i investimeve i Mutares SE & Co. KGaA përfshin 26 shoqëri, në sektorë dhe shtete të ndryshme.

Shoqëria Mutares SE & Co. KGaA dhe asnjë nga shoqëritë e grupit të saj nuk kanë filiale dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

Shoqëria Target: Efacec Power Solutions, SGPS S.A. është një shoqëri e kufizuar publike, e themeluar sipas legjislacionit portugez, me objekt aktiviteti: administrimin e kapitalit të shoqërive të tjera, si një formë e tërthortë e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, duke qenë gjithashtu në gjendje të ofrojë shërbime teknike dhe administruese në përputhje me ligjin.

Efacec Power Solutions, SGPS S.A është shoqëria mëmë e Grupit Efacec, e cila merr pjesë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive të Grupit Efacec, në marrëveshje të shumta konsorciumi, grupime plotësuese të shoqërive ose forma të tjera të ngjashme të organizimit të biznesit të krijuar në Portugali, në Evropë dhe jashtë saj (Entitetet e mbetura Efacec).

Grupi Efacec është prezent në Shqipëri nëpërmjet Degës në Shqipëri Efacec Engenharia e Sistemas, S.A., degë e shoqërisë së huaj, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë është: a) studimi, zhvillimi, dizenjimi, projektimi, prodhimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe sistemeve elektronike, elektrike etj; 2) aktivitete inxhinierike dhe konstruksioni; c) furnizimi i sistemeve menaxhuese, komandimi dhe kontrolli i rrjeteve të energjisë elektrike dhe pajisjeve industriale; d) prodhimi dhe tregtimi i sistemeve automatike, robotikës dhe ruajtja e automatizuar; e) instalimet e kondicionerëve, rrjetet e shpërndarjes së gazit, rrjetet e komunikimit, etj; f) ofrimi i shërbimeve për përdorimin e sistemeve sanitare.

Efacec Power Solutions, SGPS S.A. zotërohet në masën 71.73% nga PARPÚBLICA – Participações Públicas (SGPS), S.A. dhe në masën 28.27% nga MGI Capital, S.A.

Pala shitëse: PARPÚBLICA – Participações Públicas (SGPS), S.A. është një shoqëri me kapital ekskluzivisht publik, e krijuar sipas legjislacionit portugez, e cila ka si mision krijimin e një instrumenti të shtetit në fushën e administrimit të letrave me vlerë dhe pasurive të paluajtshme. Për sa i përket mbështetjes për menaxhimin e aksioneve në shoqëri, misioni i PARPÚBLICA – Participações Públicas (SGPS), S.A. është siguruar përmes menaxhimit të portofolit të saj dhe ofrimit të mbështetjes teknike për Ministrinë e Financave.

II. Përqendrimi

Më datë 23 qershor 2023, ndërmjet shoqërisë PARPÚBLICA – Participações Públicas (SGPS), S.A. (shitësi), Mutares Holding-65 GmbH, Mutares Holding-66 GmbH (blerësit) dhe Mutares SE & Co. KGaA (shoqëria mëmë e blerësve) është nënshkruar dokumenti “Marrëveshje për blerje aksionesh”, në lidhje me shitjen e 95% të kapitalit aksionar të Efacec Power Solutions, SGPS S.A.

Shitësi PARPÚBLICA – Participações Públicas (SGPS), S.A., në kuadër të privatizimit të shoqërisë Efacec Power Solutions, SGPS S.A., kishte nisur një proces shitjeje për aksionet e zotëruara prej tij në

këtë shoqëri.

Sipas Dekret-ligjit nr.33-a/2020, procesi i shitjes do të kryhej me anë të një shitje direkte të aksioneve përkatëse ose nënshkrimit të aksioneve të sapo-emetuara si rezultat i rritjes së kapitalit aksionar të shoqërisë Efacec Power Solutions, SGPS S.A. Shoqëria Mutares Iberia S.L. u zgjodh nga Qeveria Portugeze për të blerë nga shitësi aksionet, që përfaqësojnë 71.73% të kapitalit aksionar të paguar të shoqërisë, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Portugalisë mbi fituesin e ofertës publike mbi aksionet e Efacec Power Solutions, SGPS S.A., publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.113, datë 13.06.2023.

Referuar “Marrëveshje për blerje aksionesh”, shitësi, PARPÚBLICA – Participações Públicas (SGPS), S.A., dëshiron të shesë dhe blerësit, (filialet në pronësi të plotë të shoqërisë mëmë të blerësve dhe filialeve të Mutares Iberia S.L.), dëshirojnë të blejnë, aksionet e zotëruara nga shitësi në kapitalin aksionar të shoqërisë pas Kapitalizimit Paraparak, me qëllim që të sigurohet që Blerësit të mbajnë 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë pas Kapitalizimit Paraparak dhe përfundimit.

Marrëveshja parashikon Kapitalizimin Paraparak, i cili do të përfshijë miratimin nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë të një ulje të kapitalit në zero, me anë të mbulimit të humbjeve dhe rrjedhimisht amortizimin e të gjitha aksioneve të mëparshme, e ndjekur nga një rritje e kapitalit aksionar me emetimin e aksioneve të reja, të gjitha me të njëjtat të drejta dhe detyrime.

Këto aksione do të nënshkruhen dhe paguhen nga shitësi me anë të kontributeve në natyrë (me anë të kapitalizimit të huave të aksionarëve dhe kontributeve ndihmëse) dhe në para, dhe nga Mutares Holding-65 GmbH me anë të një kontributi në mjete monetare për të nënshkruar dhe paguar aksionet e reja të lëshuara, që përfaqësojnë 5% të kapitalit aksionar.

MGI Capital, S.A. heq dorë nga e drejta e parablerjes për të nënshkruar këtë rritje të kapitalit aksionar.

Në përfundim të Kapitalizimit Paraparak, shitësi, PARPÚBLICA – Participações Públicas (SGPS), S.A., do të jetë aksionar i 95% të kapitalit aksionar të shoqërisë dhe Mutares Holding-65 GmbH do të jetë pronar i ligjshëm i 5% të kapitalit aksionar.

Me tej, Mutares Holding-65 GmbH do të blejë nga shitësi aksionet, që përfaqësojnë 75% të kapitalit aksionar dhe të të drejtave të votimit të shoqërisë dhe Mutares Holding-66 do të blejë 20% të kapitalit aksionar dhe të drejtave të votimit të shoqërisë.

Në përfundim të transaksionit, Mutares SE & Co.KG&A (nëpërmjet Mutares Holding-65 GmbH dhe Mutares Holding-66 GmbH) do të zotërojë dhe kontrollojë 100% shoqërinë Efacec Power Solutions, SGPS S.A.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të pajisjeve për sektorin e energjisë, duke përfshirë transformatorët, pajisjet e tensionit të lartë dhe të mesëm, pajisjet e shpërndarjes parësore dhe dytësore, zhvillimin e teknologjisë së automatizimit dhe menaxhimit të rrjetit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Efacec Power Solutions, SGPS S.A. nga shoqëria Mutares SE & Co. KG&A, nëpërmjet filialeve të saj Mutares Holding-65 GmbH dhe Mutares

Holding-66 GmbH.

Pas transaksionit, Efacec Power Solutions SGPS S.A. do të zotërohet në mënyrë direkte nga Mutares Holding-65 GmbH me 80% të aksioneve dhe nga shoqëria Mutares Holding-65 GmbH me 20% të aksioneve dhe në mënyrë indirekte nga shoqëria Mutares SE & Co. KGaA.

Shoqëria Mutares SE & Co. KGaA dhe asnjë nga shoqëritë e grupit nuk kanë filiale dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

Grupi Efacec është prezent në Shqipëri nëpërmjet Degës në Shqipëri Efacec Engenharia e Sistemas, S.A, i cili ofron shërbim për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike sipas kontratës së lidhur mes tyre, ndërkohë që grupi realizon të ardhura nga shitja e pajisjeve të sektorin e transmetimit të energjisë elektrike.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Efacec Power Solutions, SGPS S.A. nga shoqëria Mutares SE & Co. KGaA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1009 , Datë 29. 08. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE GGE IRELAND LIMITED DHE EMP ENERGY LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IRELAND LIMITED”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 08. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar mbi përfutimin e kontrollit të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi se shoqëria Statkraft Ireland Limited synonte të blinte kuotat e shoqërisë GGE Ireland Limited dhe shoqërisë EMP Energy Limited.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1001, datë 17.07.2023, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm, të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited, vendosi:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitohet pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me shkresën nr. 365/8, datë 01.08.2023 “Njoftim përqendrimi dhe kërkesë për autorizim të përqendrimit”, jemi njoftuar se shoqëria Statkraft Ireland Limited ka lidhur “Marrëveshje për shitblerjen e aksioneve”, në respekt të të gjithë kapitalit të nënshkruar të EMP Energy Limited dhe GGE Ireland Limited.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitblerjen e aksioneve”, e nënshkruar në datë 24.07.2023 palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft Ireland Limited, është një shoqëri private, me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë Statkraft Ireland Limited është i përqendruar në gjenerimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike.

Statkraft Ireland Limited është shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS, shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë dhe aktori më i madh i hidroenergjisë së rinovueshme në Evropë.

Statkraft AS është shoqëria mëmë e disa filialeve të Statkraft Group dhe zotërohet tërësisht nga Statkraft FS.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA, shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Shoqëritë Target:

Shoqëria Target 1: GGE Ireland Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës, me objekt aktiviteti zhvillimin e aseteve të prodhimit të energjisë nga era, dielli dhe ruajtja e energjisë nëpërmjet baterive.

GGE Ireland Limited zotërohet plotësisht nga shoqëria Galileo Green Energy GmbH (shitësi 1).

GGE Ireland Limited zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë EMP Energy Limited (Target 2).

Shoqëria Target 2: EMP Energy Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës, me objekt aktiviteti zhvillimin e aseteve të prodhimit të energjisë nga era, dielli dhe ruajtja e energjisë nëpërmjet baterive.

Shoqëria EMP Energy Limited zotërohet në masën 50% të kapitalit të regjistruar të saj nga GGE Ireland Limited; 25% të kapitalit të regjistruar të saj nga Emerging Markets Power (Holdings) Limited dhe 25% të kapitalit të regjistruar të saj nga Wind Power Invest A/S.

Shoqëritë target nuk janë prezent dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

Pala Shitëse:

Shitësi 1: Galileo Green Energy GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit të Zvicrës dhe me veprimtari tregtare si zhvilluese dhe operatore mbarë evropiane, multi-teknologjike e energjisë së rinovueshme.

Galileo Green Energy GmbH zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë GGE Ireland Limited.

Shitësi 2: Wind Power Invest A/S është një shoqëri tregtare, e regjistruar sipas legjislacionit të Danimarkës, me objekt aktiviteti projektimin, prodhimin dhe instalimin e turbinave me erë në të gjithë globin. Wind Power Invest A/S zotëron 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë Target 2 .

Shitësi 3: Emerging Markets Power (Holdings) Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit anglez, me objekt aktiviteti: prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe tregtimin e energjisë elektrike. Emerging Markets Power (Holdings) Limited zotëron 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë Target 2.

II. Përqendrimi

Më datë 24.07.2023, ndërmjet blerësit Statkraft Ireland Limited dhe shitësve Galileo Green Energy GmbH; Wind Power Invest A/S dhe Emerging Markets Power (Holdings) Limited është lidhur Marrëveshje për shitblerjen e aksioneve, në respekt të të gjithë kapitalit të nënshkruar të EMP Energy Limited dhe GGE Ireland Limited.

Referuar kësaj marrëveshjeje, Wind Power Invest A/S dhe Emerging Markets Power kanë rënë dakord të shesin aksionet e EMP (që përbëjnë 50% të kapitalit të Shoqërisë) në pronësi të ligjshme dhe të dobishme të secilit prej tyre dhe Blerësi ka rënë dakord të blejë aksione të EMP sipas afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

Përveç kësaj, Galileo Green Energy GmbH ka rënë dakord të shesë aksionet e GGE Ireland në pronësi të ligjshme dhe të dobishme të tij dhe Blerësi ka rënë dakord të blejë aksione të GGE Ireland sipas afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

Në përfundim të transaksionit, blerësit Statkraft Ireland Limited do ti transferohen rregullisht aksionet e zotëruara në shoqërinë GGE Ireland Limited, së bashku me certifikatat e aksioneve nga shitësi Galileo Green Energy GmbH, si pronar i vetëm ligjor që zotëron 100% të kapitalit në shoqërinë target 1, si dhe do ti transferohen rregullisht aksionet e zotëruara në shoqërinë EMP Energy Limited, së bashku me certifikatat e aksioneve nga shitësit Emerging Markets Power (Holdings) Limited, i cili zotëron 25% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë target 2 dhe Wind Power Invest A/S, i cili zotëron 25% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë target 2.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë GGE Ireland Limited dhe shoqërisë EMP Energy Limited, nga shoqëria Statkraft Ireland Limited

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik

do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e aksioneve të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

Statkraft Ireland Limited zotërohet 100% nga shoqëria Statkraft AS, shoqëria mëmë e disa filialeve të Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëritë target GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited, janë shoqëri irlandeze që ushtrojnë aktivitet në fushën e energjisë së rinovueshme, energjisë së erës dhe asaj diellore në Irlandë dhe nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1010 , Datë 29. 08. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELGI SHPK NGA SHOQËRIA SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 08. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK.

Referuar “Marrëveshje shitblerje kuotash, për shit-blerjen e 100% të kuotave në DELGI SHPK”, datë 12 korrik 2023, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK (Saint-Gobain SHPK) është një shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, i themeluar sipas legjislacionit shqiptarë, e cila ka si objekt aktiviteti prodhimin, shpërndarjen dhe /ose tregtimin e materialeve të ndërtimit, si dhe transportin ndërkombëtar të mallrave.

Shoqëria Saint-Gobain SHPK zotërohet tërësisht nga shoqëria Saint-Gobain Produits Pour La Construction dhe janë pjesë grupit ndërkombëtar të shoqërive Saint-Gobain, të kontrolluara nga shoqëria Compagnie De Saint-Gobain, shoqëria mëmë e grupit Saint-Gobain.

COMPAGNIE DE SAINT-GOBAIN S.A., është një shoqëri aksionare, e cila ka si objekt, si në Francë dhe jashtë saj: administrimin dhe vlerësimin e asetëve të tanishme dhe të ardhshme të shoqërisë dhe realizimin për këto qëllime të të gjitha operacioneve të nevojshme qoftë në mënyre indirekte, qoftë nga ajo vetë, në fushat si vijon: prodhim, transformim, përpunim, pastrim, shpërndarje të të gjitha produkteve dhe substancave natyrore ose sintetik, të thjeshta apo të përbëra, etj.

Shoqëria target: DELGI SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptarë. Shoqëria ushtron aktivitetin në fushën e shfrytëzimit të mineraleve të grupeve 1,2,3,4; projektim dhe ndërtim minierash dhe karrierash, prodhimin e lëndëve të para të ndërtimit, konsulencë, import eksport materialesh dhe pajisje për minierat e karrierat, transport nacional dhe internacional të mallrave etj.

Shoqëria DELGI SHPK, zotërohet në 50 % të kapitalit nga znj. Kozeta Lamaj; 40% të kapitalit nga z. Mirgen Dervishi dhe 10% të tij nga z. Adhurim Çausi.

Pala shitëse: znj. Kozeta Lamaj; z. Mirgen Dervishi dhe z. Adhurim Caushi , shtetas shqiptarë.

II. Përqendrimi

Më datë 12 korrik 2023, ndërmjet shoqërisë SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK (blerësi) dhe znj. Kozeta Lamaj; z. Mirgen Dervishi dhe z. Adhurim Caushi (shitësit) është nënshkruar dokumenti “Marrëveshje shitblerje kuotash, për shit-blerjen e 100% të kuotave në DELGI SHPK”.

Referuar pikës 2 të marrëveshjes “Shitja dhe Blerja”, në momentin e mbylljes dhe në bazë të kushteve të kësaj marrëveshjeje, secili nga shitësit i shet blerësit dhe ky i fundit, duke u mbështetur në garancitë dhe zotimet e shitësve të përcaktuar në këtë marrëveshje, blen çdo kuotë të parënduar nga asnjë Barrë së bashku me të gjitha të drejtat që i bashkëngjiten çdo kuote të tillë në Datën e Mbylljes.

Referuar pikës 4.1 të marrëveshjes “Kushtet paraprake”, palët janë të detyruar ti nënshtrohen plotësisht të kushteve, ku ndërmjet tyre parashikohet që: -Autoriteti i konkurrencës duhet të këtë dhënë Autorizimin e Konkurrencës; -Agjencia Kombëtare e Mjedisit të mos këtë dhënë asnjë koment në lidhje me planin e rehabilitimit të paraqitur nga shoqëria dhe - AKBN të këtë miratuar planin vjetor të punës për aktivitetet minerare për periudhën korrik 2023-korrik 2024.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i nxjerrjes dhe shitjes me shumicë të mineralit të gips alabastër. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria Saint-Gobain SHPK e zhvillon aktivitetin e saj në 2 drejtime kryesore:

- Prodhimin, nën arkën Saint-Gobain Weber, të një gamë të gjerë produktesh për tregun shqiptar, si dhe eksportimin në Kosovë dhe në rajon. Produktet e saj përfshijnë materiale të thata ndërtimi si llaç

suvatimi, llaçra murature, finitura minerale dekorative, finitura dhe stuko të imta, ngjitës pllakash, izolante dhe llaçra me bazë gipsi të markës Rigips.

- Shpërndarjen në Shqipëri dhe Kosovë të materialeve dhe zgjidhjeve për sisteme të thata të markës Saint-Gobain Rigips; sisteme për izolim termik prej leshit të xhamit dhe leshit të gurit të markës Saint-Gobain Isover dhe Isocam; sisteme të performancës akustike për ambiente publike nga Saint-Gobain Ecophon dhe Eurocoustic; produkte të gatshme me kova për sistemet fasadë, mureve të brendshme dhe të jashtme të markës Saint –Gobain Weber, sisteme xhami nga Saint-Gobain dhe membrana bituminoze për izolim Bituver.

Shoqëria DELGI SHPK ka filluar aktivitetet në vitin 2011 dhe nëpërmjet Akt Miratimit nr. 1553/2012 “Për transferimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr. 1213 datë 07.07.2008, në objektin “Bistricë”, Sarandë për shfrytëzimin e mineralit të gips alabastër”, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës miratoi transferimin e lejes të shfrytëzimit nga shoqëria Tabaku SHPK në shoqërinë DELGI SHPK. Me VKM nr. 136 datë 22.02.2017 “Për heqjen nga fondi pyjor dhe pakësimin në volum të sipërfaqes në ngastrat 41A, 42 dhe 43A, në objektin e quajtur “Bistricë”, Delvinë që do të përdoren nga shoqëria “DELGI” SHPK për shfrytëzimin e mineralit të gips alabastër”, qeveria zgjeroi sipërfaqen e shfrytëzimit me 29.4 ha, në Dhrovjan, Delvinë, Sarandë. Në zbatim të VKM , shoqëria është pajisur me lejen nr. PN-6737-07-2018, miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1213/1 datë 05.07.2018, e vlefshme deri në datë 07.07.2028.

Sipas Regjistrimit të lejeve minerare aktive shkurt/2023 të AKBN, në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të pajisur me leje për shfrytëzim të mineralit gips alabastër 4 subjekte, tre nga të cilat në zonën e Kavajës dhe shoqëria DELGI SHPK në Delvinë. Referuar sasisë në km² të sipërfaqes së shfrytëzimit, shoqëria DELGI SHPK zotëron xx % të sipërfaqes totale për shfrytëzim në Shqipëri dhe pjesa tjetër nga 3 subjekte në zonën e Kavajës.

Transaksion i njoftuar krijon një mbivendosje të aktivitetit të palëve në nivelin vertikal, duke e klasifikohet si përqendrim vertikal, i cili ndodh në tregun e brendshëm.

Përqendrimet vertikale janë ato përqendrime ku ndërmarrjet pjesëmarrëse në të ushtrojnë veprimtarinë në nivele të ndryshme të zinxhirit të prodhimit. Përqendrimet vertikale kanë më pak mundësi të shkaktojnë kufizime të konkurrencës. Këto përqendrime pritet të sigurojnë eficienta ekonomike për shkak të uljes së kostove duke i bërë më konkurrues ndërmarrjet pjesëmarrëse në treg.

Mbivendosja vertikale mes aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në transaksionin e njoftuar do të prekë produktin:

- *pllaka gipsi*. Shoqëria Saint –Gobain SHPK është aktiv në tregun e shitjes së pllakave të gipsit, të cilat aktualisht janë produkte importi. Sipas palës njoftuese, shoqëria për shkak të investimit në teknologji, nuk ka në planin afatshkurtër prodhimin e pllakave të gipsit.
- *Materiale me bazë gipse, llaçra*. Prodhimi i këtyre materialeve kërkon investime në sistemin e bluarje-tharjes, nëpërmjet impiantit GPP (Gypsum Processing Plant), i cili nuk është në objektivin e afërt të shoqërisë.

Për këto arsye nuk pritet që, në planin afatshkurtër, transaksioni të ketë efekte mes aktivitetit të palëve në nivelin vertikal, duke ndërthurur aktivitetet e tyre.

Mbështetur në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, pjesa e tregut të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në transaksion përbën treguesin e parë të prekjes së tregut nga transaksioni.

Sipas vlerësimit të shoqërisë blerëse, Saint –Gobain SHPK zotëron rreth xx % të tregut të shitjes së pllakave të gipsit dhe materialet e tjera të ndërtimit, ndërkohë që referuar të dhënave ekonomike të

shoqërisë target, rezulton se të ardhurat e shoqërisë kanë ardhur në ulje gjatë vitit 2022 dhe janë me të ulëta se shoqëritë e tjera të cilat kanë sipërfaqe shfrytëzimi me të vogël se DELGI SHPK. Këto të dhëna tregojnë për mungesë të efikasitetit ekonomike të shoqërisë DELGI SHPK dhe pjesa që zotëron shoqëria në tregun e nxjerrjes dhe shitjes së mineralit të gips alabastër varion nga xx % në vitin 2020 në xx % në vitin 2022.

Nga analiza e realizuar u konstatua se si pala blerëse, ashtu edhe shoqëria target zotërojnë pjesë të vogël në tregjet ku operojnë dhe për më tepër mbivendosja vertikale në produktet e prekura nga transaksioni nuk ka gjasa të ndihet në periudhë afatshkurtër pas transaksionit të synuar, pasi kërkohen investime në teknologji.

Transaksioni i njoftuar nuk ka gjasa të çojë në përjashtimin e konkurrentëve aktuale apo pengimin e konkurrentëve potenciale nga tregu, pasi çdo konkurrent në treg është i pajisur me leje shfrytëzimi në një territor të caktuar gjeografik. Hyrja e konkurrentëve në tregun e nxjerrjes së mineralit të gips alabastër është politike e institucioneve qeverisëse në kuadër të politikave të shfrytëzimit të burimeve natyrore.

Shoqëria target aktualisht po ndien mungesën e klientëve dhe përfitimi i kontrollit nga shoqëria Saint-Gobain SHPK do të përmirësojë treguesit e saj ekonomik, për shkak të shitjes së produkteve në degët/filialet e grupit Saint-Gobain në rajon.

Në përfundim të analizës konstatohet se, përfitimi i kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK do të krijojë mbivendosje vertikale në aktivitetin e palëve pjesëmarrëse në transaksion, e cila pritet të sjellë rritjen e kapacitetit nxjerrës dhe përpunues të shoqërisë target, DELGI SHPK, si dhe ulje të kostove të lëndës së parë dhe përmirësim të efikasitetit ekonomike të shoqërisë blerëse Saint-Gobain SHPK.

Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1011 , Datë 13.09. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË MESSER SE & CO. KGAA DHE TOYOTA TSUSHO EUROPE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.09. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Messer SE & Co. KGaA dhe Toyota Tsusho Europe.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Messer SE & Co. KGaA dhe Toyota Tsusho Europe,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët/ joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Messer SE & Co. KGaA dhe Toyota Tsusho Europe.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Jo-Detyruese”, nënshkruar më datë 9 maj 2023, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala 1: Messer SE & Co. KGaA (Messer), një shoqëri komandite, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e: gazeve të të gjitha llojeve; makinerive, impianteve, pajisjeve dhe materialeve ndihmëse, veçanërisht për prodhimin, lëngëzimin, ndarjen dhe pastrimin e gazeve dhe përzierjeve të gazit, si dhe ruajtjen, tregtimin, matjen, testimin, kontrollin dhe aplikimin e gazeve; gazeve mjekësore dhe pajisjeve laboratorike etj.

Messer kontrollohet tërësisht nga shoqëria Messer Holding GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar,

themeluar sipas ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë dhe menaxhohet nga *aksionari me përgjegjësi individuale* Messer Management SE, i cili siguron burimet e nevojshme dhe personelin për menaxhimin e shoqërisë.

Messer është pjesë e Messer Group, i cili është i pranishëm në Shqipëri përmes shoqërisë së kontrolluar indirekt prej saj, Messer Albagaz SHPK.

Messer Albagaz SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me aktivitet prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e gazrave industrial, mjekësor dhe special, si dhe të pajisjeve që lidhen me to; ofrimin e shërbimeve të inxhinierisë (Engineering) si dhe tregtimin e materialeve dhe ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me pajisjet e prerjes dhe saldimit dhe me teknologjinë e veshjes apo shkrijes, si edhe kryerjen e transportit të mallrave për nevojat e veta dhe të tretëve në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala 2: Toyota Tsusho Europe, (Toyota Tsusho) është një shoqëri publike me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Mbretërisë së Belgjikës. Qëllimi i shoqërisë është prodhimi, montimi dhe shitja në çdo formë, ku përfshihet edhe përfaqësimi, importi dhe eksporti, shitja dhe blerja, riparimi, mirëmbajtja, dhënia dhe pranimi i licencave, zhvillimi dhe tregtimi i patentave, ofrimi i shërbimeve, aktivitetet e ndërmjetësimit përkundrejt komisionit, në lidhje me të gjitha materialet metalike, produktet farmaceutike, si dhe të të gjitha mjeteve dhe pjesëve të automjeteve, makinerive, veglave dhe të të gjitha produkteve të kërkuara ose të nevojshme për prodhimin dhe shitjen e tyre etj.

Toyota Tsusho është filial në pronësi të plotë të Toyota Tsusho Corporation, shoqëri tregtare e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit japonez.

Toyota Tsusho Europe dhe Toyota Tsusho Corporation nuk ushtrojnë aktivitet dhe nuk kanë filiale në Shqipëri.

Ndërmarrja e Përbashkët (JV) do të themelohet në formën e një shoqërie gjermane me përgjegjësi të kufizuar dhe do të ketë objekt aktiviteti koordinimin dhe ofrimin e shërbimit për operatorët e flotës së mjeteve motorike në Evropë, duke përfshirë, sipas rastit, sigurimin e mjeteve të lëvizshme me hidrogjen (të dhëna me qira nga JV), shërbimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe menaxhimit të flotës, si dhe sigurimin e hidrogjenit të kërkuar të prodhuar nga burimet e rinovueshme (hidrogjen i gjelbër), i cili do të shpërndahet nëpërmjet një impianti prodhimi në vend apo me kamionë, pajisje dhe shërbime të tjera që mund të kërkojnë, me fokus fillestar në rajonin e Këlnit.

JV nuk pritet, të paktën në një fazë fillestare, të jetë aktive në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë 09 maj 2023, ndërmjet palëve Messer SE & Co. KGaA dhe Toyota Tsusho Europe është nënshkruar “Marrëveshje Jo-Detyruese.

Kjo marrëveshje përshkruan kushtet kryesore tregtare të propozuara për krijimin e mundshëm të një ndërmarrje të përbashkët. JV do të kontrollohet në mënyrë të barabartë nga palët në marrëveshje, 50% nga Messer SE & Co. KGaA dhe 50% nga Toyota Tsusho Europe.

JV do të ofrojë një zgjidhje gjithëpërfshirëse “me një ndalesë” për operatorët e flotës, që nuk është ofruar më parë nga Messer Group dhe Toyota Tsusho dhe të cilët nuk mund ta ofrojnë individualisht.

JV do të krijohet për një periudhë afatgjatë dhe të pacaktuar dhe do të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme.

Kjo marrëveshje nuk përbën marrëveshjen ligjërish të detyrueshme për asnjë palë për të përfunduar transaksionet e propozuara. Marrëveshja përfundimtare dhe detyruese e palëve do të përmbahet vetëm në dokumentacionin përfundimtar dhe detyrues, që do të lidhet më pas ndërmjet palëve.

Marrëveshja Jo-Detyruese është e vlefshme pas nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në nënshkrimin e

Dokumentacionit Detyrues të transaksionit. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse palët nuk nënshkruajnë dokumentacionin detyrues të transaksionit brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, kjo marrëveshje, si dhe të gjitha diskutimet ndërmjet palëve, në lidhje me projektin do të konsiderohen të përfunduara.

Komisioni Evropian, më datë 29 qershor 2023, ka autorizuar këtë transaksion duke e deklaruar në përputhje me tregun e brendshëm.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i dhënies me qira, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së flotës së automjeteve të lëvizshme me hidrogjen, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si dhe referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Referuar dokumentacionit të depozituar, janë evidentuar këto tregje të prekura nga transaksioni:

- Dhënia më qira, menaxhimi dhe mirëmbajtja e flotës.

JV do t’ju ofrojë operatorëve të flotës automjete në formën e një modeli pagese për përdorim, shërbim me një ndalesë. Për këtë qëllim, JV do ti ofrojë operatorit të flotës disa elementë të mekanizmave të qerasë financiare¹ dhe/ose operacionale².

Shërbimi i menaxhimit të flotës do të përfshijë shërbimet e këshillimit në lidhje me strukturën e flotës dhe zgjedhjen e mjetit që do të blihet; shërbime në lidhje me blerjen e mjetit në emër dhe për llogari të shoqërisë qiradhënëse; shërbimet e mirëmbajtjes së automjetit; administrimi, regjistrimi, sigurimi, menaxhimi i mjeteve zëvendësuese dhe pjesët e këmbimit.

JV këto shërbime do ti marrë nga Toyota Tsusho Europe dhe do t’ia ofrojë klientit si pjesë e shërbimit me një ndalesë.

Shoqëria Messer SE & Co. KGaA nuk është aktive në këtë segment të tregut dhe Messer Albagaz SHPK nuk ofron këtë lloj shërbimi në tregun vendas.

- Prodhimi dhe shitja e hidrogjenit

Referuar rasteve të përqendrimeve në tregjet e gazrave industriale, Komisioni Evropian ka evidentuar se, për shkak të dallimeve fiziko-kimike të gazrave dhe qëllimit të përdorimit, çdo gaz duhet trajtuar si një treg i veçantë.

Automjetet e flotës, që do të ofrohen nga JV, do të përdorin hidrogjenin si lëndë djegëse dhe furnizimi më hidrogjen është pjesë e shërbimit të menaxhimit të flotës.

Burimet kryesore të prodhimit të hidrogjenit janë nafta, gazi natyror dhe uji. Në varësi të teknologjisë së prodhimit të tij, hidrogjeni (H₂) ndahet sipas kodeve hidrogjen i zi, hidrogjen gri, hidrogjen blu, hidrogjen turkuaz, hidrogjen i gjelbër, hidrogjen i verdhë dhe hidrogjen vjollce/kuq.

Autoriteti Francez i Konkurrencës, në rastin 21-DCC-18 datë 29 janar 2021 “Përftimi i kontrollit të

¹ Qiraja financiare funksionon kryesisht si një hua që qiradhënësi mund ti mundësojë qiramarrësit për blerjen e një aktivi të caktuar. Ndryshe nga qiraja operacionale, me pagesën e kështit të fundit, pronësia ligjore e automjetit i kalon klientit;

² Në një qira operacionale pronësia ekonomike dhe ligjore e automjetit i mbetet qiradhënësit, i cili duhet të përballojë të gjitha rreziqet që lidhen me pronën;

përbashkët të Dijon Metropole Smart Energy nga Dijon Metropole Storengy dhe Rougeot Energie Invest”, evidentoi se pavarësisht ndryshimit në proceset teknologjike të prodhimit të H₂, të gjitha proceset prodhojnë të njëjtin produkt përfundimtar (molekulën e hidrogjenit), gjë që mund të favorizojë mos-segmentimin e mëtejshëm të tregut të prodhimit të hidrogjenit.

Flota e automjeteve të JV do të përdorë hidrogjenin e gjelbër, i cili përftohet nga procesi i elektrolizës së ujit. JV nuk do të ketë një proces prodhimi të caktuar, por do të përshtasë procesin e prodhimit sipas projekteve specifike dhe nevojave individuale të klientëve.

Nëpërmjet Messer, JV do të ndërtojë për çdo klient një elektrolizer të dedikuar, infrastrukturë për furnizimin me kamion, një pikë të karburantit me hidrogjen, duke përfshirë edhe pajisjet e mbajtjes nën presion të mesëm, i cili do të jetë pronësi e JV.

Sipas deklaratës së palës njoftuese, shoqëria Messer Albgaz SHPK importon dhe shet sasi të vogla hidrogjeni në Shqipëri, por në asnjë rast për përdorim për automjete dhe për pasojë nuk pritet të ketë një mbivendosje horizontale mes aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në ndërmarrjen e përbashkët. Pjesa e tregut e shoqërisë Messer Albgaz do të mbetet e pandryshuar edhe pas përqendrimit, pasi ky transaksion nuk do të krijojë efekte horizontale apo të rrjedhës së sipërme e të poshtme në tregun shqiptar.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Messer SE & Co. KGaA dhe Toyota Tsusho Europe, i cili në fazën fillestare do ta ushtroje aktivitetit në Këln, Gjermani.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Messer SE & Co. KGaA dhe Toyota Tsusho Europe.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1012 , Datë 13.09. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VRUMONA B.V. NGA SHOQËRIA ROYAL UNIBREW A/S NËPËRMJET SHOQËRISË COMPANY OF JUNE 2023 B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.09. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vrumona B.V. nga shoqëria Royal Unibrew A/S nëpërmjet shoqërisë Company of June 2023 B.V.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vrumona B.V. nga shoqëria Royal Unibrew A/S nëpërmjet shoqërisë Company of June 2023 B.V.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Vrumona B.V. nga shoqëria Royal Unibrew A/S nëpërmjet shoqërisë Company of June 2023 B.V.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitblerje”, të nënshkruar më datë 03 korrik 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Company of June 2023 B.V. është një shoqëri holding, me formë juridike të shoqërisë private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit holandez, si një ndërmarrje me qëllime të veçanta (SPV), për të vepruar si palë blerëse në këtë përqendrim.

Blerësi mëmë/Garantuesi: Royal Unibrew A/S është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas legjislacionit danez. Royal Unibrew A/S është shoqëria mëmë e grupit të shoqërive Royal Unibrew Group, për shitjen e pijeve të ndryshme, me portofol solid të markave lokale në tregjet kryesore në

rajonin nordik, vendet baltike, Itali, Francë dhe Kanada. Shoqëria Royal Unibrew A/S do të jetë garantuesi i SPV-së në këtë transaksion.

Royal Unibrew A/S, nuk ka asnjë filial në Shqipëri.

Pala shitëse: Heineken Nederlands Beheer B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit holandez, me aktivitet tregtar: shoqëri mbajtëse aksionesh.

Heineken Nederlands Beheer B.V. nuk ka filiale ose prezencë në Shqipëri.

Shoqëria Target: Vrumona B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit holandez, me aktivitet tregtar: prodhim i pijeve joalkoolike; prodhim i ujërave minerale dhe ujërave të tjerë të ambalazhuar; prodhimi i lëngjeve të frutave dhe perimeve; tregtia me shumicë e pijeve (jo produkte qumështi).

Target zotëron 100% filialin Energie Conversie Maatschappij Bunnik B.V.

Energie Conversie Maatschappij Bunnik B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti në fushën e Transportit, Komunikimeve, Shërbimeve Elektrike, Gazit, Sanitareve dhe Shërbimeve elektrike.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Heineken Nederlands Beheer B.V. (shitësi), shoqërisë Company of June 2023 B.V. (blerësi) dhe shoqërisë Royal Unibrew A/S (blerësi mëmë), është lidhur “Marrëveshje shitblerje”, datë 03 korrik 2023.

Referuar kësaj Marrëveshjeje shitblerjeje, shitësi Heineken Nederlands Beheer B.V. dëshiron t’i shesë aksionet blerësit dhe blerësi, Company of June 2023 B.V. dëshiron t’i blejë të gjitha aksionet nga shitësi, në varësi të kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Blerësi Mëmë është i gatshëm dhe në gjendje të garantojë detyrimet dhe angazhimet e blerësit sipas kësaj Kontrate.

Pas përfundimit, shoqëria Heineken Nederlands Beheer B.V. do t’i transferojë shoqërisë Company of June 2023 B.V. aksionet pa ndonjë barrë, me anë të ekzekutimit të Aktit të Transferimit, në përputhje me Marrëveshjen.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe tregtimit të pijeve freskuese, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundi i kontrollit të shoqërisë Vrumona B.V. nga Royal Unibrew A/S nëpërmjet shoqërisë Company of June 2023 B.V.

Company of June 2023 B.V. është një ndërmarrje me qëllime të veçanta për realizimin e këtij transaksioni, e zotëruar 100% nga Royal Unibrew A/S.

Royal Unibrew A/S është një shoqëri aksionare, aktive në shitjen e pijeve të ndryshme, përfshirë birrën, pijet me malt, pijet freskuese, pijet energjike, ujin, verën, etj. në tregjet kryesore në rajonin nordik, vendet baltike, Itali, Francë dhe Kanada.

Royal Unibrew Group nuk ka filiale në Shqipëri, por ka realizuar shitje nëpërmjet një distributori të kontraktuar nga filiali i saj italian.

Target Vrumona B.V. është një shoqëri aktive në prodhimin e pijeve joalkoolike; prodhimi i ujërave minerale dhe ujërave të tjerë të ambalazhuar; prodhimi i lëngjeve të frutave dhe perimeve dhe tregtia me shumicë e tyre. Vrumona B.V. nuk kryen veprimtari eksporti. Transaksioni do të realizohet në Holandë dhe nuk do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në tregun shqiptar.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vrumona B.V. nga shoqëria Royal Unibrew A/S nëpërmjet shoqërisë Company of June 2023 B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 1013, Datë 19. 09.2023

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK DHE NDËRMARRJES AUTO HOLIDAY ALBANIA SHPK NË TREGUN E SHËRBIMIT TAKSI PËR UDHËTARË NGA DHE DREJT AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.09.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”.

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi me Vendimin nr. 984, datë 11.5.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, për periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 11 maj 2023.
2. Referuar sjelljes së ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 44 të Ligjit nr. 9121/2003, vlerësoi se mund të jemi përpara një rasti urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

3. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK për lejimin e aksesit pa kushte për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës dhe heqjen e tabelës me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, e cila ndalon dhënien e këtij shërbimi në shkelje të Ligjit nr. 9121/2003.
4. Në zbatim të këtij vendimi, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

5. Në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
6. Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, për nga vet natyra është një facilitet esencial për kryerjen e transportit ajror. Në këtë facilitet përfshihen të gjitha shërbimet brenda një aeroporti të cilat bëjnë të mundur sigurimin e një pasagjeri për të arritur nga destinacioni A tek B, duke përfshirë kështu edhe shërbimin me taksi nga/drejt Aeroportit TIA.
7. TIA ka përzgjedhur ndërmarrjen Auto Holiday Albania SHPK (AHA), e cila është përgjegjëse të ofrojë shërbimin taksi për transport udhëtarësh me vendndodhje të mjeteve në zonën e qëndrimit jashtë Terminalit të Pasagjerëve, që nga viti 2019. Ky subjekt është i licencuar për ofrimin e këtij shërbimi nga Bashkia Krujë dhe realizon transport nga Aeroporti i Tiranës me destinacion vendndodhjen e kërkuar nga pasagjeri.
8. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 984, datë 11.5.2023, problematika konsiston në sjelljen e ndërmarrjes TIA SHPK me mos lejimin e aksesit nga ndërmarrje të tjera që ofrojnë shërbimin e taksive për udhëtarë nga aeroporti drejt Tiranës të cilët nuk kanë pasagjerë brenda.
9. Referuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit është tregu i shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës (TIA).
10. Tregu përkatës gjeografik është Nikël (Rinasi), në të cilin TIA SHPK ushtron aktivitetin e pranë Aeroportit “Nënë Tereza” (TIA).

III. Masa e përkohshme

11. Referuar sjelljes së ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, ndodhur përballë një situatë urgjence, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për

konkurrencën në këtë treg, për një shkelje të mundshme të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 44, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 9121/2003, me Vendimin nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi:

- I. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, si vijon:
 - a. Lejimin e aksesit pa kushte për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
 - b. Të heqë tabelën me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, e cila ndalon dhënien e këtij shërbimi në shkelje të ligjit nr. 9121/2003.

II. Masat e përkohshme duhet të zbatohen me marrjen dijani të këtij vendimi.

III. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.

IV. Në rast të moszbatimit të vendimit për masën e përkohshme të cituar në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrja Tirana International Airport SHPK ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (b) të ligjit nr. 9121/2003.

12. Ky vendim ju njoftua ndërmarrjes TIA SHPK gjatë inspektimit të datës 31.05.2023 si dhe nëpërmjet shkresës nr. 272/13 prot., datë 24.05.2023 “Njoftim Vendimi”.

13. Grupi i Inspektimit ka kryer inspektime pranë zyrave qendrore të ndërmarrjes TIA SHPK në datat 22.05.2023, 31.05.2023 dhe 07.06.2023.

14. Gjatë inspektimit të datës 22.05.2023, nga ana e përfaqësueseve të ndërmarrjes TIA SHPK, pasi u vunë në dijeni për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës dhe shqetësimet e konkurrencës në këtë treg, u mor iniciativa për rishikimin e tabelës ndaluese në hyrje të zonës “Kiss and Fly”.

15. Ndërmarrja TIA, nëpërmjet shkresës nr. 272/14 prot., datë 29.05.2023 “Dërgim dokumentacioni në lidhje me inspektimin e datës 22.5.2023 dhe kthim përgjigje mbi shkresën nr. 2701/13 prot., datë 24.02.2023 “Njoftim Vendimi””, është shprehur se me largimin e grupit të inspektimit të AK, stafi i menaxhimit të aeroportit vendosi heqjen e tabelës përkatëse, ku sipas TIA u reflektua që në orët e para të mëngjesit të ditës vijuese. TIA bashkëlidhur kësaj shkrese ka bashkëngjitur dhe disa foto për të treguar edhe masat konkrete që janë marr për heqjen e tabelës “Ndalohet taksi pa pasagjerë”.

16. Në vijim të zbatimit të masës së përkohshme edhe pse pas dërgimit të fakteve nga ndërmarrja TIA SHPK ku tregohet se TIA ka zbatuar masën e përkohshme duke hequr tabelat përkatëse (sipas foto 1 dhe 2), grupi i inspektimit në datën 31.05.2023 u paraqit pranë aeroportit ndërkombëtar të Tiranës për të verifikuar në qoftë se tabela sipas shkresës së TIA-s ishte reflektuar. Grupi inspektimit evidentoi se në hyrjen e zonës “Kiss and Fly” pranë aeroportit të TIA, tabela me shkrimin “Ndalohet

taksi pa pasagjerë”, ishte hequr, në zbatim të pikës “b” të vendimit nr. 987, datë 24.05.2023.

17. Gjithashtu për zbatimin e pikës “a” të Vendimit nr. 987, datë 24.05.2023, me datë 07.06.2023, grupi i inspektimit u paraqit pranë zonës “Kiss and Fly” të TIA, nga ku u faktua me procesverbal që lejohej aksesimi pa kushte për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
18. Sa më sipër, rezulton se ndërmarrja Tirana International Airport SHPK ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”.

IV. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

19. Vlerësimi i pozitës dominuese në treg është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, për sjellje të mundshme antikonkurruese në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të Ligjit, përkatësisht: “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
20. Sipas Ligjit nr. 9121/2003, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të Ligjit nr. 9121/2003.
21. Aeroporti ndërkombëtar i Tiranës, për nga vet natyra është një facilitet esencial për kryerjen e transportit ajror. Në këtë facilitet përfshihen të gjitha shërbimet brenda një aeroporti të cilat bëjnë të mundur sigurimin e një pasagjeri për të arritur nga destinacioni A tek B, duke përfshirë kështu edhe shërbimin me taksi nga/drejt Aeroportit TIA.
22. TIA-s nëpërmjet Marrëveshjes së Koncesionit, i është dhënë e drejta ekskluzive dhe e vetme që gjatë afatit të koncesionit të ndërtojë, të vendosë në punë, operojë dhe mirëmbajë aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe është subjekti i vetëm që menaxhon (vetë ose nëpërmjet nënkontraktorëve) zonën e koncesionit, ku përfshihet dhe zona Kiss & Fly (vendqëndrimi i shpejtë i lënies dhe marrjes së pasagjerëve, deri në 4 minuta).
23. TIA ë kuptim të nenit 9, të Ligjit nr. 9121/2003, ka një pozitë dominuese duke patur 100% të tregut përkatës. Duke u bazuar në Ligj dhe në Udhëzimin “Për vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese”, por edhe në praktikat më të mira të Komisionit Europian dhe të OECD, ndërmarrja Tirana International Airport SHPK, ka një mundësi potenciale të maksimizojë fitimet duke refuzuar aksesin për të ofruar shërbimin me taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës edhe nga ndërmarrje të tjera që ofrojnë shërbimin.

24. Bazuar në marrëveshjen koncesionare për të gjithë periudhën e koncesionit ndërmarrja Tirana International Airport SHPK, operon e vetme pranë Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës.
25. Duke marrë parasysh faktin që ndërmarrja Tirana International Airport SHPK është posedues, operues, menaxhues dhe administrues i vetëm i infrastrukturës dhe faciliteteve të aeroportit ndërkombëtar të Tiranës (Nënë Tereza), duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut përkatës, si dhe barrierat për hyrjen në treg; konkurrencën potenciale; fuqinë kundërvepruese të blerësve, bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Tirana International Airport SHPK vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës (TIA).

V. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun përkatës

26. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe shoqëria koncesionare Tirana International Airport SHPK, kanë lidhur marrëveshjen fillestare të koncesionit, më datë 15 tetor 2004 (Marrëveshja fillestare e koncesionit), e ratifikuar përmes Ligjit nr. 9312, datë 11 nëntor 2004, “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar ‘Nënë Tereza’, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare”. (ndryshuar me Ligjin nr. 55/2016 dhe Ligjin nr. 16/2021).
27. Sipas pikës 2, germa “C”, Qeveria e Shqipërisë dhe Shoqëria lidhin këtë Kontratë me qëllim përcaktimin e kushteve dhe afateve në bazë të të cilave Shoqëria, ndër të tjera, ka të drejtë:
- të projektojë, financojë, instalojë, ndërtojë, vërë në punë, mirëmbajë, operojë, administrojë dhe zhvillojë Terminalin e Ri dhe Ndërtimet e Reja dhe Ndërtimet e Reja Shtesë në Zonën e Koncesionit;
 - të përdorë dhe të ripajisë Terminalin Ekzistues, Vendndodhjen e Terminalit Ekzistues, Aktivitet Përkatës dhe Zonën e Koncesionit;
 - të ketë në pronësi Ndërtimet e Reja;
 - të gëzojë Uzufuktin mbi Terminalin Ekzistues, Sheshin e Terminalit Ekzistues, Aktivitet Përkatës dhe Zonën e Koncesionit për të paktën njëzet (20) vjet³; dhe
 - të lidhë kontrata për blerjen e çdo aktivi, të përmbushë detyrimet dhe ushtrijë të drejtat sipas kësaj Kontrate.
28. Në pikën 2.1.a (v) të Ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004, Qeveria e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar, i jep Shoqërisë, të drejtën e vetme dhe ekskluzive që gjatë Afatit të

³ Ndryshuar sipas ligjit nr. 16/2021 “a) Koncesioni jepet për një afat kohor (tridhjetë e pesë) vjet, duke filluar nga data e fillimit (Afati i koncesionit).”.

Koncesionit të kryejë Projektin në Zonën e Koncesionit dhe, pa kufizim, të drejtat për të: projektuar, financiar, operuar, ndërtuar, vënë në punë, mirëmbajtur, administruar dhe zhvilluar Fazën A të Parkimit të Automjeteve dhe Fazën B të Parkimit të Automjeteve.

29. Sipas shtojcës 27, pika 2, paragrafi 2, të Kontratës së Koncesionit, shoqëria do të projektojë, ndërtojë dhe mirëmbajë Parkingun e Makinave në fazën A, që përfshin hapësirën për parking autoveturash me qëndrim të gjatë dhe të shkurtër për një minimum prej 500 autoveturash ose kamionësh në afërsi të Terminalit të Ri, që do të jetë i zgjerueshëm, dhe do të përfshijë zonat për pritjen e taksive, furgonëve dhe hipjen e zbritjen nga autobusat dhe për parkim.
30. Aeroporti ndërkombëtar i Tiranës konsiderohet një facilitet esencial, duke qenë se ofron shërbime transporti të rëndësishme për njerëzit dhe mallrat. Aeroportet luajnë një rol kritik në lidhjen e njerëzve dhe bizneseve në pjesë të ndryshme të botës, duke lehtësuar tregtinë dhe duke mundësuar udhëtime për arsye pune, turizmi dhe qëllime të tjera. Si rezultat shumë qeveri, përfshirë edhe Qeverinë Shqiptare, i klasifikojnë aeroportet si infrastrukturë të një rëndësie të veçantë dhe marrin masa për të siguruar mbarëvajtjen e tyre në mënyrë të sigurtë.
31. Sipas Marrëveshjes së Koncesionit, pikës 2.1.a (XII) TIA gëzon të drejtën ekskluzive për zhvillim komercial të Zonës së Koncesionit si dhe të nënshkruajë kontrata të drejtpërdrejta me palët e treta në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm.
32. TIA ka për qëllim të nënshkruajë një marrëveshje me një kompani të licencuar për shërbimin taksi.
33. Sipas Ligjit nr. 8308/1998 “Për Transportet rrugore”, i ndryshuar, neni 35, specifikon se Këshilli Bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet. Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë përkatëse, në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.
34. Tirana International Airport SHPK zotëron pozitë dominuese, pasi është i vetmi subjekt i cili ofron një facilitet esencial si aeroporti ndërkombëtar i Tiranës.
35. Për sa më sipër, TIA ka përzgjedhur ndërmarrjen Auto Holiday Albania SHPK (AHA), e cila është përgjegjëse të ofrojë shërbimin taksi për transport udhëtarësh me vendndodhje të mjeteve në zonën e qëndrimit jashtë Terminalit të Pasagjerëve. Ky subjekt është i licencuar për ofrimin e këtij shërbimi nga Bashkia Krujë dhe realizon transport nga Aeroporti i Tiranës me destinacion vendndodhjen e kërkuar nga pasagjeri.
36. Referuar Kontratës së Shërbimit “Për shërbimin taksi në Terminalin e Pasagjerëve të Tirana International Airport” të lidhur mes TIA dhe AHA, shërbimi i taksive në aeroportin e Tiranës sigurohet nga kompania Auto Holiday Albania (AHA). Kompania AHA është e specializuar në lëvizjen me taksitë e aeroportit në/nga Tirana, e më tej në të gjithë qytetet e Shqipërisë për individë dhe grupe individësh.
37. Kontrata mes dy ndërmarrjeve fillimisht ka qenë e vlefshme për periudhën nga 01.05.2019 deri në

30.04.2024, duke ndryshuar me shtojcën nr. 2 të hartuar në 19.07.2021 ku në nenin 2 palët kanë rënë dakord të zgjasin afatin e Kontratës së Ndryshuar duke filluar nga data 01.05.2024 deri në 15.07.2031 (kontratë me një afat 12 vjeçar).

38. Bazuar në kontratën fillestare, TIA e lejon AHA të ushtrojë shërbimin taksi në terminalin e pasagjerëve të TIA dhe të parkojë 5 taksi në ambientet përballë Terminalit të Pasagjerëve në zonën e marrjes së pasagjerëve (referuar si “Ambientet”) dhe 20 taksi në zonën e kthesës së ambienteve të parkimit, kundrejt një pagese mujore prej 9 000 Euro pa TVSH. Gjatë sezonit të pikut ky numër mund të rritet me dy taksi pas një kërkesë në formë të shkruar dhe me miratimin e TIA-s. Në shtojcën nr.1 të hartuar në 17.01.2020 palët kanë rënë dakord se duke nisur nga data 01.03.2020, AHA-s i lejohet të parkojë 3 taksi të tjera shtesë në ambientet përballë Terminalit të Pasagjerëve për një vlerë shtesë prej 1 000 euro në muaj pa TVSH; duke e çuar pagesën totale mujore ndaj TIA-s në vlerën 10 000 euro pa TVSH.
39. Në kontratën fillestare, AHA i paguan TIA-s Tarifën Mujore në shumën prej 9 000 Euro pa TVSH. Në shtojcën nr. 2 të hartuar në 19.07.2021 palët kanë rënë dakord se duke filluar nga data 16.07.2021 e në vijim AHA do t’i paguajë TIA-s Tarifën Mujore prej 27 500 Euro pa TVSH dhe Tarifa Mujore do të jetë subjekt i rishikimit nga palët një herë në dy vjet.
40. Sipas informacionit të marrë nga TIA dhe shkresës protokolluar pranë AK me nr. 272/9 prot., datë 19.05.2023 “Përgjigje ndaj njoftimit të vendimit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 984 datë 11.05.2023”, të dërguar nga TIA, ndërmarrja Auto Holiday Albania është ndërmarrja e vetme e ofruar dhe e përzgjedhur që ofron shërbimin taksi brenda Aeroportit të Tiranës.
41. Në faqen zyrtare të AHA⁴, jepet mundësia për të rezervuar taksi si edhe janë të publikuara çmimet që aplikon ndërmarrja për transportin e udhëtarëve. Udhëtimi nga aeroporti drejt Tiranës kushton 23 deri në 28 Euro, ndërsa udhëtimet më të lira janë drejt Vorës dhe Fushë-Krujës me 14 Euro. Qytetet kryesore siç janë Durrësi, kanë një tarifë që varion nga 28 deri në 32 Euro, Kruja kushton 28 Euro, Vlora 103 Euro, Shkodra varion nga 65 në 74 Euro etj. Destinacion më i shtrenjtë është ai drejt qytetit të Delvinës, i cili kushton 205 Euro.
42. Sipas OECD⁵, termi "refuzim për furnizim/shërbim" përshkruan një situatë në të cilën një ndërmarrje refuzon t'i shesë një ndërmarrjeje tjetër, ose është e gatshme të shesë vetëm me një çmim që konsiderohet "shumë i lartë" ose e gatshme të shesë vetëm në kushte që konsiderohen të papranueshme.
43. Referuar kapitullit II, germa “A”, pika (1) të Udhëzimit “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121, datë 23.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës””, qëllimi i forcimit të aktivitetit të Autoritetit në lidhje me sjelljen përjashtuese është të sigurojë që ndërmarrja me pozitë dominuese të mos dëmtojë konkurrencën efektive duke përjashtuar rivalet e tyre në mënyrë anti konkurruese dhe kështu duke pasur një ndikim të kundërt në mirëqenien konsumatore, gjë që mund të realizohet nëpërmjet rritjes së çmimeve, kufizimeve të cilësisë dhe kufizimeve të zgjedhjes konsumatore. Me

⁴ <https://tiataxi.al/travel/>

⁵ OECD Round Tables “Refusal to Deal” 2007

“përrjashtim anti-konkurrese” do të kuptojmë një situatë kur hyrja efektive e konkurrentëve aktuale ose potencial të ofertuesve ose tregjeve është penguar ose eliminuar si rezultat i sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese, nëpërmjet të cilës kjo ndërmarrje është në një pozicion përfitues nga rritja e çmimeve në dëm të konsumatorëve. Identifikimi i konsumatorëve të dëmtuar mund të mbështetet në cilësinë dhe kur është e mundur dhe e përshtatshme dhe në evidenca sasiore.

44. Sipas kapitullit II, germa “A”, pika (2) e Udhëzimit “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121, datë 23.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti, bazuar në nenin 9, ndërhyr kur mbi bazën e evidencave të forta dhe bindëse, sjellja e supozuar abuzuese është e pritshme të çojë në përrjashtime anti-konkurrese. Autoriteti merr në konsideratë ndër të tjera pozicionin e ndërmarrjes me pozitë dominuese. Në përrgjithësi, sa më e fortë të jetë pozita dominuese aq më e madhe është mundësia që sjellja që mbron këtë pozicion të çojë në përrjashtime anti-konkurrese
45. Nëpërmjet kontratës së shërbimit taksi të lidhur me ndërmarrjen AHA, e cila është e vetmja ndërmarrje që ofron shërbim taksi për pasagjerë nga Aeroportit ndërkombëtar i Tiranës drejt një destinacioni tjetër, tarifrat që kjo ndërmarrje aplikon për itinerarin TIA - Tiranë janë relativisht të larta me një tarifë prej 2500 lekë⁶ – 2900 lekë (20 –28 Euro⁷) në krahasim me ndërmarrjet e tjera që ofrojnë të njëjtin itinerar me tarifa që variojnë nga 990 lekë⁸ – 1 300 lekë / 9.49 – 12.46 Euro).⁹
46. Pavarësisht se ndërmarrja TIA ka zbatuar VKK nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, fakti që deri në momentin e konstatimit nga Autoriteti i Konkurrencës ndërmarrja Tirana International Airport SHPK ka vendosur në zonën e jashtme të mbërritjeve (ose ndryshe zona Kiss&Fly) tabelën me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, si dhe nuk ka lejuar ofrimin e shërbimit dhe taksive të tjera që operojnë në treg, brenda territorit të Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës, i cili për nga vet natyra është një facilitet esencial për kryerjen e transportit ajror si dhe kjo ndërmarrje është poseduese dhe administuese e vetme e infrastrukturës dhe faciliteteve të aeroporti ndërkombëtar të Tiranës, duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut përkatës, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sjellja e TIA mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese duke refuzuar aksesin dhe ndërmarrjeve të tjera që janë të licensuara dhe që ofrojnë shërbimin e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi nga aeroporti drejt Tiranës apo një destinacioni tjetër.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

⁶ <https://www.tirana-airport.com/sq/transport-and-directions/13/By-Taxi>

⁷ <https://tiataxi.al/travel/>

⁸ https://www.instagram.com/p/CqpVg0sNZW7/?img_index=1 (Merr Taxi)

⁹ 1 euro = 104.3 lekë

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar Të Tiranës.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 15 tetor 2023.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1014, Datë 21.09.2023

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PRODHIMIT, TRANSMETIMIT DHE SHITJES NË MËNYRË DIXHITALE TË PRODUKTEVE AUDIO DHE VIDEO, TEK OPERATORËT KABLLORË (Ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor)”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.09.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (Ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor), ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA”.

Bazë ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d), neni 26, neni 43, pika 5, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (Ripërtëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor), ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA”;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit paraprak; si dhe,
- Sqarimeve të dhëna nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në takimin e zhvilluar pranë Autoritetit të Konkurrencës më datë 10.07.2023, ora 10:00, mbi problematikat e konstatuara gjatë hetimit paraprak në tregun përkatës, objekt hetimi.

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Bazuar në ankesat e paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrjet/ operatorë kabllorë: XXX SHPK dhe XXX SHPK kundrejt ndërmarrjes Digitalb SHA lidhur me sjelljen e saj në ofrimin e shërbimit ndaj Operatorëve Kabllorë në tregun e TV me pagesë, Sekretariati i Autoritetit

të Konkurrencës ka filluar procedurën për vlerësimin e këtyre ankesave në respektim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

2. Referuar rezultateve të këtij vlerësimi, Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 940, datë 27.12.2022 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (Ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor) ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA, për periudhën kohore nga 1 Janar 2020 deri në 31 Dhjetor 2022, për të parë nëse ka shkelje të nenit 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 398/11, datë 27.12.2022 “Autorizim inspektorësh”, inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit paraprak proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjes nën hetim Digitalb SHA, e cila ushtron veprimtarinë e saj në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video.
4. Gjatë procedurës së hetimit paraprak, u zhvilluan inspektime tek operatorët kabllorë: XXX SHPK, XXX SHPK dhe XXX SHPK, si dhe u mor takim me përfaqësues të Shoqatës së Transmetuesve Televiziv Kabllorë e Valorë Lokale - RTL, dhe të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).
5. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit paraprak janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja Digitalb SHA dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA).
6. Në vazhdim të procedurës, Komisioni i Konkurrencës, më datë 10.07.2023, ora 10:00 zhvilloi një takim sqarues me përfaqësues të Autoritetit të Mediave Audiovizive lidhur me gjetjet e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (Ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor) ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA. Qëndrimi i AMA-s mbi gjetjet e hetimit paraprak është marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës dhe është reflektuar në vendimarrjen e këtij Komisioni.

II. RREGULLIMI LIGJOR I TREGUT

7. Veprimtaria e mediave audiovizive rregullohet nga ligji nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
8. Në kuptim të nenit 4 (gërmat a dhe d) të ligjit nr. 97/2013, “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë. Kjo veprimtari garanton të drejtën e çdo shtetasi për të marrë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të ofruara për publikun nga operatorët e shërbimeve audiovizive, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
9. Autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë është Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA).

10. Referuar ligjit nr. 97/2013, ndërmarrjet ofruese të shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA-të), e interesuara për ofrimin e shërbimit si operatorë të rrjetit numerik në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video në territorin e RSH-së, duhet të pajisen me licencë nga AMA.
11. Për ndërmarrjet (OSHMA-të) operatorë të shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor ose kabllor, sipas ligjit specifik nr. 97/2013, “Për Median Audiovizive” miratimi bëhet me autorizim të AMA-s, pa garë, mbi bazën e kërkesës, me detyrimin të jenë paraprakisht të regjistruar në AKEP.
12. Bazuar në nenin 24 “Shërbimet pa pagesë (free to air)”, të rregullores së AMA-s nr. 219/2016, i licencuari për transemtimin audioviziv kombëtar siguron që të gjithë dekoderët që ofron vetë në shitje të kenë aftësinë të marrin dhe shfaqin transmetimet e hapura free to air të të gjithë rrjeteve numerike kombëtare, rajonale dhe lokale në një zonë të caktuar. Udhëzuesi elektronik i programeve i inkorporuar në këta dekodera siguron që shërbimet e hapura të shfaqen në ekran dhe të zgjidhen nga shikuesit pa i detyruar ata të paguajnë ndonjë tarifë.
13. AMA, në përmbushje të funksioneve të saj, si rregullator i tregut të shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, në zbatim të ligjit nr. 97/2013, “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” (neni 19), ndër të tjera: - zgjidh mosmarrëveshjet midis ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik; - kontrollon zbatimin e këtij ligji nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të këtij ligji dhe, në rast shkeljesh, vendosjen e sanksioneve; - monitoron programet e transmetuara nga OSHMA-të; - kontrollon cilësinë e marrjes së sinjaleve në zonat e mbulimit dhe kërkon zgjidhje për ankesat e publikut për cilësinë e transmetimit të sinjaleve audiovizive; AMA realizon bashkëpunimin dhe këshillimin me AKEP-in, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj. Në bazë të nenit 19, pika 16, të ligjit nr. 97/2013, AMA nxjerr vendime në zbatim të funksioneve të veta dhe të këtij ligji.
14. Sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr.97/2013, AMA analizon periodikisht efektet e ndryshme në tregun e transmetimeve, me qëllim ushtrimin sa më të përshtatshëm të funksioneve të veta rregullatore. Për këtë qëllim AMA mund të bashkëpunojë me institucionet përkatëse publike dhe me ofruesit e shërbimeve mediatike.
15. AMA lëshon licenca dhe/ose autorizime, si dhe siguron zbatimin e kushteve të licencave dhe/ose autorizimeve të lëshuara prej saj (neni 23, pika 1/a/c). Në zbatim të nenit 69, pika 2, AMA ka të drejtë të heqë licencën dhe/ose autorizimin kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në licencë.
16. OSHMA-të kabllorë për përsëritjen e programeve (kanaleve) të të tretëve, nënshkruajnë kontrata/marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre programeve. Ky detyrim i OSHMA-ve, buron nga neni 32, pika 6, e ligjit nr. 97/2013, ku përcaktohet se: “OSHMA-të duhet të transmetojnë programet, përfshirë veprat kinematografike, në përputhje me kushtet dhe afatet për të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre veprave”. Mosrespektimi i këtij detyrimi nga ana e të licencuarit ose autorizuarit (transmetimi (përsëritja) e programeve pa pasur më parë një kontratë, ose marrëveshje me mbajtësin përkatës të së drejtës së transmetimit) përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 133, pika 7, të ligjit nr. 97/2013.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

III.1 Tregu përkatës

17. Përcaktimi i tregut përkatës është elementi kryesor i analizës së konkurrencës. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik. Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121/2003 dhe Udhëzimin nr. 76, datë 07.06.2008, “Për përcaktimin e Tregut Përkatës”, Tregu përkatës i produktit përcaktohet si: *“Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”*.
18. Referuar faktorëve të vlerësimit të tregut përkatës, në rastin objekt hetimi si treg përkatës të produktit do të vlerësojmë: *Tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor)*.
19. Meqenëse shërbimi i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor) ofrohet në të gjithë territorin, atëherë *treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë*.
20. Për sa më sipër, *tregu përkatës në këtë rast është konsideruar: Tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor), në territorin e Republikës së Shqipërisë*.

III.2 Struktura e tregut

21. Transmetimi i sinjalit televiziv nga prodhimi deri te konsumatori fundor mund të realizohet në forma të ndryshme, por ekzistojnë tre lloje kryesore të modeleve të ofrimit: Satelitore; Rrjetet tokësore (p.sh. shpërndarja kabllore); dhe OTT.
22. Prodhimi i përmbajtjes i referohet një grupi të tërë aktivitetesh me qëllim të krijimit të informacionit për të arritur një audiencë të synuar dhe kjo realizohet p.sh nëpërmjet emisioneve, dokumentarëve, dublimeve të filmave, komentimit të ndeshjeve, përkthimeve të emisioneve, dokumentarëve, etj.
23. Në total nga AMA, janë dhënë 7 frekuenca për transmetimet audiovizive (në formën e platformave), nga të cilat dy frekuenca i ka operatori publik RTSH, dhe pesë frekuencat e tjera i ka Digitalb Tv, Top Chanel, ADTN, Tv Klan dhe Media Vizion.
24. Referuar të dhënave të AMA, në tregun e prodhimit operojnë gjithsej 45 OSHMA Audiovizive (TV) publike, private dhe kombëtare të licensuara.
25. OSHMA-të audiovizive prodhojnë përmbajtje dhe transmetojnë programet e tyre, të cilat janë të ndryshme nga njëra - tjetra dhe kanë detyrimin të transmetojnë programacionin e tyre pa pagesë në rrjetin e tyre. Në këtë kuptim mund të themi se çdo OSHMA audiovizive zotëron pozitë dominuese për programacionin e vet në rrjetin e tij.
26. Për transmetim audioviziv në satelit janë licencuar nga AMA dy platforma numerike satelitore, Digitalb SHA dhe Tring SHA.

27. Në tregun audioviziv operojnë dhe operatorët kabllorë me pagesë, të cilët janë të licencuar dhe operojnë si ripërsëritës programi, të cilët transmetojnë vetëm nëpërmjet teknologjive që nuk mbështeten në frekuenca (kabëll, rrjet komunikimesh elektronike, IPTV etj.). Këta operatorë gjithashtu ofrojnë në treg paketa kanalesh televizive me pagesë dhe ritransmetojnë paketat Digitalb dhe Tring. Këta operatorë mbeten thjesht shpërndarës të programeve të të tretëve, duke përdorur rrjetin e tyre.
28. Sipas të dhënave të administruara nga AMA për vitin 2020 janë 64 operatorë kabllorë të licencuar si ripërsëritës programi dhe për vitin 2021, 65 operatorë kabllorë të licencuar si ripërsëritës programi nga AMA.
29. Për sa më sipër operatorët kabllorë nuk janë në të njëjtin treg me platformat Digitalb dhe Tring, pasi operatorët kabllorë nuk prodhojnë përmbajtje (kontent), por vetëm ripërsëritin programet e platformave Digitalb dhe Tring ku janë të përfshira dhe përmbajtjen e disa kanaleve të tjera televizive.
30. Gjithashtu, referuar të dhënave të AMA-s, në vendin tonë operojnë edhe 30 OSHMA që ushtrojnë aktivitetin në internet OTT/IPTV.
31. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës ndodh në rastet kur një rritje e çmimeve e bën një produkt më pak të pëlqyer nga konsumatorët, të cilët vendosin të blejnë më pak nga ai dhe më shumë nga produktet alternative zëvendësuese.
32. OSHMA-të audiovizive, pra televizionet publike, private apo kombëtare prodhojnë dhe transmetojnë programacionin e tyre, i cili është i ndryshëm nga njëri TV tek tjetri, prandaj dhe janë të pazëvendësueshëm ndërmjet tyre.
33. Dy platformat satelitore Digitalb dhe Tring prodhojnë, transmetojnë dhe shesin në mënyrë digjitale produkte audio dhe video dhe kanë në përmbajtje të tyre kanale me filma, programe të ndryshme, kanale sportive dhe kanale kombëtare, ku Digitalb përmban kanalet kombëtare Top Chanel dhe Klan, ndërsa Tring përmban kanalin kombëtar Vizion Plus. Për sa i përket kanaleve me filma dhe programeve të tjera dy platformat Digitalb dhe Tring mund të jenë të zëvendësueshme për konsumatorët, pasi ata ofrojnë një shumëllojshmëri programacioni, ndërsa për sa i përket kanaleve kombëtare dhe sportive nuk janë të zëvendësueshme. Ato konsumatorë që duan të shohin kanalet Top Chanel dhe Klan duhet të kenë platformën Digitalb dhe për të parë Vizion Plus duhet të kenë platformën Tring.
34. OSHMA-të kabllore të autorizuara për ripërsëritjen e programit audioviziv me pagesë, të cilat nuk prodhojnë vetë përmbajtje (kontent), por vetëm përsëritin programet e platformave Digitalb dhe Tring, si dhe përmbajtjen e disa kanaleve të tjera televizive kombëtare publike dhe private (si Digitalb TV, TV Klan, Top Chanel, Vizion Plus, etj.) janë të zëvendësueshme me njëra-tjetrën në zonën gjeografike ku operojnë.
35. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës ndodh nëse ofruesit janë të aftë të këmbëjnë produktet e tyre me produktet e tregut përkatës dhe t'i tregtojnë ato në periudha afatshkurtra pa sjellë kosto shtesë, në përgjigje të ndryshimeve të vogla ose të përhershme të çmimeve. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës mund të themi se midis OSHMA-ve audiovizive, satelitore dhe ripërsëritësve të programit (operatorët kabllorë) nuk ka zëvendësueshmëri nga ana e ofertës, për shkak të teknologjisë së ndryshme të transmetimit të sinjalit.

36. Ligji nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në asnjë dispozitë të tij nuk përcakton dhënien e të drejtave ekskluzive apo të veçanta për ndërmarrje të caktuara të cilat operojnë në tregun e e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video në territorin e RSH-së.
37. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë Operatorët aplikantë për t`u pajisur me Licencë dhe/ose Autorizim, kushtet për regjistrim, si dhe vlera e garancive janë vendosur duke pasur parasysh natyrën e veçantë e specifike në tregun që operohet, bazuar edhe në të dhënat teknike të këtij tregu dhe janë të njëjta për të gjithë ndërmarrjet e interesuara për t`u licencuar dhe/ose *Autorizuar, duke i vendosur ata përballë kushteve të barabarta dhe jo diskriminuese.*
38. Hyrja në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video kërkon investime të mëdha, investime të cilat përbëjnë barriera të larta ekonomike për hyrjen në tregun përkatës.
39. Në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video nuk ekzistojnë barriera ligjore, por ka barriera ekonomike për futjen në këtë treg të ndërmarrjeve të reja.
40. AMA në zbatim të ligjit nr. 97/2013 analizon periodikisht efektet e ndryshme në tregun e transmetimeve, me qëllim ushtrimin sa më të përshtatshëm të funksioneve të veta rregullatore. Për këtë qëllim AMA mund të bashkëpunojë me institucionet përkatëse publike dhe me ofruesit e shërbimeve mediatike.
41. Sipas konstatimeve të AMA-s në takimin e zhvilluar me KK më datë 10.07.2023, “ Nuk ka raporte të mirëfilta pa pasur një matës audience ... Për shkak të vlerave të larta që matësi audiencës kërkon vit pas viti, askush nga OSHMA-të në Shqipëri nuk është gati të financojë këtë lloj shërbimi Në momentin që Shqipëria do të ketë një kompani të huaj apo shqiptare që do bëjë matësin e audiencës, në atë moment do të kuptohet pesha specifike e gjithësecilit në treg ... Sot jemi në kushtet pa një instrument të tillë mbi bazën e të cilit dhe mund të formojmë opinione ... Matësi i audiencës është një nga sfidat që nuk i shtrohet autoritetit, rregullatorit... Matësi i audiencës duhet bërë nga vetë kompanitë”.

IV. SJELLJA E NDËRMARRJES DIGITALB SHA

42. Nisur nga ankesat e paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA, të cilat konsistojnë në sjelljen e Digitalb SHA lidhur me ofrimin e shërbimit ndaj OSHMA-ve Kabllorë, vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes nën hetim u fokusua në marrëdhëniet kontraktore me operatorët kabllorë dhe kontratat me të drejta ekskluzive të saj me televizionet kombëtare për ofrimin e shërbimit në këtë treg nga ana e ndërmarrjes Digitalb SHA.
43. Referuar ankesave të OSHMA-ve Kabllorë: XXX SHPK, XXX SHPK, XXX SHPK, XXX SHPK dhe XXX, vihet re se: ndërmarrjet DigitAlb SHA, TV Klan dhe Top Channel, kanë hyrë në një marrëdhënie juridike civile ndërmjet tyre, për kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca dhe/ose autorizimi (ritransmetimi ekskluziv i kanaleve të platformës TV Klan dhe Top Channel). Objekt i këtyre kontratave është kalimi i të drejtës ekskluzive të distribucionit të paketës së kanaleve televizive TV Klan dhe Top Channel për transmetim në platformën tokësore dhe satelitore; shërbim

OTT. Me anë të këtyre kontratave, operatorët e kanaleve televizive i japin Digitalb-it ekskluzivitetin e distribucionit të programeve të tyre në televizionin me pagesë. Në këtë mënyrë përmbajtjet pa pagesë të këtyre kanaleve televizive, bëhen gjithashtu pjesë e përmbajtjeve me pagesë në tregun e televizionit me pagesë me një cilësi të shtuar.

44. Sa më sipër, si dhe sipas konstatimeve të AMA-s në takimin e zhvilluar me KK, TV Klan dhe Top Channel kanë përmbushur detyrimin e tyre ligjor, pasi këto dy shoqëri operojnë “on air” në bazë të ligjit dhe digjitalizimit, ato kanë pika transmetuese (japin kontentin e tyre me antenë) kudo në territorin e Shqipërisë dhe ofrojnë shërbimin e tyre falas (Shërbimet pa pagesë (free to air)).
45. Referuar ankesave, ripërsëritësit kabllorë kanë shfaqur shqetësime, se Digitalb nuk rinovonte kontratat/marrëveshjet për ritransmetimin e paketës “Digit-Alb”, pavarësisht faktit se disa nga këto subjekte kanë pasur marrëveshje të mëparshme me Digitalb. Sipas ankuesve pamundësia për të hyrë në marrëdhënie juridike me Televizionet Kombëtare, ka ardhur si pasojë e zbatimit të kontratave me të drejta ekskluzive, nga Digitalb SHA me Operatorët Televizivë pa pagesë.
46. Bazuar në ankesat e ndërmarrjeve OSHMA Kabllorë, lidhur me pretendimin e tyre për refuzim nga ana e ndërmarrjes Digitalb SHA, vihet re se marrëdhënia juridike që krijohet në tregun e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive është një marrëdhënie juridike civile që e rregullon Kodi Civil i R.SH dhe ligji nr. 97/2013 “Për median audiovizive në RSH”, si dhe aktet nënligjorë të dala në zbatim të tij.
47. Referuar ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në RSH”, OSHMA-të kabllorë për përsëritjen e programeve (kanaleve) të të tretëve, nënshkruajnë kontrata/marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre programeve. Konkretisht ky detyrim i OSHMA-ve, buron nga neni 32, pika 6, e ligjit nr. 97/2013, ku përcaktohet se: “OSHMA-të duhet të transmetojnë programet, përfshirë veprat kinematografike, në përputhje me kushtet dhe afatet për të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre veprave”. Mosrespektimi i këtij detyrimi nga ana e të licencuarit ose autorizuarit (transmetimi (përsëritja) e programeve pa pasur më parë një kontratë, ose marrëveshje me mbajtësin përkatës të së drejtës së transmetimit) përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga AMA sipas nenit 133, pika 7, të ligjit nr. 97/2013.
48. Sa më sipër, sipas konstatimeve të AMA-s, problematika midis Digitalb SHA dhe operatorëve kabllorë, kryesisht ka ardhur për shkak të piraterisë televizive nga ana e TV kabllor. Digitalb SHA ka ngritur pretendimin pranë AMA-s se këta subjekte ndër vite e kanë piratuar, duke i shkaktuar një dëm kompanisë. Për këtë arsye Digitalb SHA ka argumentuar se nuk mund t’i rinovonte kontratat. Në këtë situatë Bordi i AMA-s për disa nga këta subjekte ka marrë vendime me gjoba.
49. Gjithashtu referuar konstatimeve të bëra gjatë procedurës hetimore mbi problematikën e krijuar midis Digitalb SHA dhe operatorëve kabllorë XXX SHPK, XXX SHPK, XXX SHPK, XXX SHPK dhe XXX, si dhe konstatimeve të AMA-s në takimin e zhvilluar me KK, e cila ka deklaruar se ka shqyrtuar këto ankesa të paraqitura shumë kohë më parë pranë saj, rezulton se:
 - ndërmarrja XXX SHPK, më datën XXX ka nënshkruar me Digitalb SHA kontratën “Marrëveshje për transmetimin e paketave Digitalb”;
 - ndërmarrja XXX SHPK ka hequr dorë nga autorizimi në AMA duke dalë nga tregu, por aktualisht në zonën ku operonte XXX SHPK, ushton aktivitetet një subjekt tjetër, i cili ka kontratë për transmetimin e paketave me Digitalb SHA;

- problematika me XXX SHPK është zgjidhur pasi është lidhur marrëveshja me shoqërinë Digitalb;
- XXX SHPK është në proces shitje;
- XXX SHPK ka lidhur kontratë me subjektin Digitalb SHA.

50. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes Digitalb SHA kundrejt operatorëve kabllorë ka ardhur për arsye objektive, siç janë arsyet e ligjshme tregtare. Në këto kushte ajo është zgjidhur bazuar në ligjin e posaçëm dhe AMA ka marrë të gjitha masat në mënyrë që kjo problematikë të mos jetë më prezente në treg.

51. Pavarësisht sa më sipër, duke qenë se të gjithë operatorët OSHMA audiovizive kanë pozitë dominuese për programacionin që prodhojnë në rrjetin e tyre, ata kanë detyrimin që t'u japin të drejtën e ritransmetimit të programeve të tyre të gjithë operatorëve të interesuar, në çdo segment tregu, në përputhje me ligjet e zakonet e mira tregtare. Ofrimi i këtij shërbimi nuk mund të refuzohet pa një arsye të ligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja d), nenin 26, nenin 43, pika 5, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor).
- II. Detyrimin e të gjithë operatorëve OSHMA audiovizive, si operatorë me pozitë dominuese, që tu japin të drejtën e ritransmetimit të programeve të tyre të gjithë operatorëve të interesuar, në çdo segment tregu.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1015 , Datë 21.09. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË D WAY DOO NGA SHOQËRIA NELT CO. DOO BEOGRAD DHE PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË D WAY NGA SHOQËRIA NEREGELIA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.09. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë D Way Doo nga shoqëria Nelt Co. Doo Beograd dhe përfimit të kontrollit të shoqërisë D Way nga shoqëria Neregelia.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë D Way Doo nga shoqëria Nelt Co. Doo Beograd dhe përfimit të kontrollit të shoqërisë D Way nga shoqëria Neregelia,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfimin e kontrollit të shoqërisë D Way Doo nga shoqëria Nelt Co. Doo Beograd dhe përfimit të kontrollit të shoqërisë D Way nga shoqëria Neregelia.

Referuar dokumentit “Kontratë Shitblerje”, të nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:

Pala Blerëse:

Blerësi 1: Nelt Co. Doo Beograd, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Serbisë, me objekt aktiviteti: shitjen me shumicë të sheqerit, çokollatave dhe ëmbëlsirave. Shoqëria Nelt Co. Doo Beograd është pjesë e Grupit Nelt.

Blerësi 2: Neregelia është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Malit të

Zi, me objekt aktiviteti: shitja me shumicë e parfumeve dhe produkteve kozmetike. Neregelia zotërohet 100% nga Neregelia Trading Limited.

Blerësi 1 dhe Blerësi 2 i përkasin dhe operojnë brenda shoqërive të grupit Nelt.

Grupi Nelt ofron shërbime të integruara të distribucionit dhe logjistikës tek konsumatorët e tij të brendshëm dhe ndërkombëtar, përmes një rrjeti qendrash distribucioni dhe mbështetjesh operacionale në çdo vend në të cilin ai është i pranishëm.

Grupi Nelt ka një filial në Shqipëri, shoqërinë Nelt SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti import-eksporti dhe tregtimi me shumicë dhe me pakicë i të gjithë artikujve industrialë, të konsumit të gjerë, ushqimore, kinkalerie, tregtim i produkteve kozmetike, farmaceutike dhe i karburanteve të ndryshme etj.

Nelt SHPK është në pronësi të plotë të Neregelia Trading Limited, shoqëria mëmë e Grupit Nelt.

Pala shitëse: Prelimio Holdings Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Qipros. Prelimio Holdings Limited zotëron 100% shoqëritë target D Way Doo dhe D Way.

Shoqëritë Target:

- **Target 1: D Way Doo (Serbia)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Serbisë, me objekt aktiviteti: shitjen me shumicë të sheqerit, çokollatave dhe ëmbëlsirave.
- **Target 2: D Way (Montenegro)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Malit të Zi, me objekt aktiviteti: shitjen me shumicë të sheqerit, çokollatave dhe ëmbëlsirave.

Target 1 dhe 2 nuk janë prezent dhe nuk gjenerojnë të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë [...], shoqëria Nelt Co. Doo Beograd (blerësi 1), shoqëria Neregelia (blerësi 2) dhe shoqëria Prelimio Holdings Limited (shitësi) kanë nënshkruar “Kontratë shitblerje” në lidhje me shitblerjen e 100% të aksioneve të shoqërive D Way Doo Serbia dhe D Way Doo Montenegro.

Referuar kësaj Kontrate Shitblerjeje, shitësi dëshiron të shesë dhe transferojë dhe Blerësi 1 do të blejë nga shitësi 100% të aksioneve në D Way Serbia.

Shitësi dëshiron të shesë dhe transferojë dhe Blerësi 2 do të blejë nga shitësi 100% të aksioneve në D Way Montenegro, në përputhje me dispozitat dhe kushtet e kësaj kontrate.

Në përfundim të transaksionit, Nelt Co. Doo Beograd do të zotërojë 100% shoqërinë D Way Serbia dhe Neregelia do të zotërojë 100% shoqërinë D Way Montenegro.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Grupi Nelt ofron shërbime të integruara të shpërndarjes dhe logjistikës tek klientët e tij vendas dhe ndërkombëtarë, nëpërmjet një rrjeti qendrash shpërndarje dhe mbështetjes operacionale në çdo vend që ai është aktiv.

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimeve të logjistikës të biznesit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Logjistika e biznesit është procesi i planifikimit, realizimit dhe kontrollit të efikasitetit, rrjedhës ekonomike dhe magazinimit të lëndëve të para, produkteve të gatshme dhe informacionit të lidhur nga pika e origjinës deri në pikën e konsumit në përputhje me kërkesat e klientit.

Koncepti i logjistikës së biznesit mundëson integrimin e plotë të aktiviteteve të biznesit që lidhen me shpërndarjen (shitjen me shumicë) e mallrave të konsumit. Logjistika e biznesit përfshin koordinimin e aktiviteteve që lidhen me komunikimin në kanalet e shpërndarjes, parashikimin e kërkesës, kontrollin e inventarit, menaxhimin e mallrave, transportin, magazinimin, shërbimin ndaj klientit dhe të tjera.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërisë D Way Doo nga shoqëria Nelt Co. Doo Beograd dhe përftrimi të kontrollit të shoqërisë D Way nga shoqëria Neregelia.

Nelt Co. Doo Beograd dhe Neregelia i përkasin dhe operojnë brenda grupit të shoqërive Nelt.

Grupi Nelt realizon të ardhura dhe është prezent në Shqipëri nëpërmjet filialit të tij Nelt SHPK, i cili operon në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të artikujve industrial dhe ushqimor.

Shoqëritë Target ofrojnë një shërbim të plotë për klientët nga importi dhe zhdoganimi i mallrave, nëpërmjet aktiviteteve të marketingut, deri te shitjet dhe dorëzimi. Shoqëritë target nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë D Way Doo nga shoqëria Nelt Co. Doo Beograd dhe përfimit të kontrollit të shoqërisë D Way nga shoqëria Neregelia.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1016 , Datë 21.09. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE MHB WIND FARMS (HOLDINGS) LIMITED DHE TAURBEG LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IRELAND LIMITED.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.09. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive MHB Wind Farms (Holdings) Limited dhe Taurbeg Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive MHB Wind Farms (Holdings) Limited dhe Taurbeg Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi transaksionin e blerjes së kuotave të shoqërive MHB Wind Farms (Holdings) Limited dhe Taurbeg Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

Referuar “Marrëveshje shitblerje kuotash”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft Ireland Limited është një shoqëri irlandeze e cila zhvillon, ndërton, zotëron dhe operon projekte të energjisë së rinovueshme. Ajo ka përvojë në një gamë të larmishme teknologjish si energjia nga era, diellore, asetet e ruajtjes së energjisë dhe shërbimet e rrjetit. Gjithashtu kjo shoqëri është e përfshirë në gjenerimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me enegji elektrike.

Statkraft Ireland Limited zotërohet 100% nga shoqëria Statkraft AS, shoqëria mëmë e disa filialeve të Grupit Statkraft. Grupi Statkraft zhvillon dhe operon asete të energjisë së rinovueshme që përfshin

hidrocentralet, solar, gaz dhe biomasë, ofron shërbime energjie për ngrohje, shet dhe blen energji. Statkraft është kompani lider në botë në operimin e hidrocentraleve dhe prodhuesi më i madh në Europë i energjisë nga hidrocentralet.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Statkraft Renewables Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA është një shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisve prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 Mw energji në Luginën e Devollit, përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse:

Shitësi 1: The Renewables Infrastructure Group (Uk) Investments Limited, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas regjistrimit të shoqërive për Anglinë dhe Uells-in.

Shitësi 2: Wind Farm Holdings Limited, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Mbretërinë e Bashkuar.

Shoqëritë Target:

Target 1: MHB Wind Farms (Holdings) Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Irlandez, me objekt aktiviteti: zhvillimi i veprimtarive tregtare si shoqëri holding dhe përfitimi përmes blerjes, qirasë, koncesioneve, granteve, licensave, të drejta opsioni, privilegje, toka, qira ndërtesash, aksione, kuota, interesa të kthyeshëm, polica sigurimi etj, si dhe të mbajë, të zhvillojë, të japë me qera, të shesë, të disponojë, të asistojë ose të marrë pjesë në transaksione financiare, tregtare, industriale dhe transaksione të tjera, ndërmarrje dhe veprimtari tregtare të çdo lloji si dhe të koordinojë për administrimin e kompanive etj; të blejë, shesë, hipotekojë, barrësojë, jap me qira, të përfitojë dhe/se të merret me çdo pronë të lirë të luajtshme dhe të paluajtshme, etj.

Target zotëron 100% filialin MHB Wind Farms Limited.

MHB Wind Farms Limited (Filiali MHB) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Irlandez dhe me aktivitet kryesor: kërkime të tjera dhe zhvillime eksperimentale mbi shkencat natyrore dhe inxhinierinë.

Shoqëria Target 2: Taurbeg Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit irlandez, me objekt aktiviteti: gjenerimi i energjisë nga era; zhvillimi dhe promovimi i gjenerimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, shpërndarja dhe furnizimi i saj; përftimi përmes blerjes, qirasë, shkëmbimit ose marrjes së opsioneve mbi tokat dhe pasurive të tjera të çdo lloji; blejë, shesë, hipotekojë, barrësojë, jap me qira, të përfitojë dhe/se të merret me çdo pronë të lirë të luajtshme dhe të paluajtshme, etj.

II. Përqendrimi

Referuar “Marrëveshje shitblerje kuotash”, e nënshkruar datë 19 gusht 2023, shoqëritë The Renewables Infrastructure Group (Uk) Investments Limited dhe Wind Farm Holdings Limited kanë rënë dakord të shesin dhe shoqëria Statkraft Ireland Limited ka rënë dakord të blejë aksionet sipas kushteve dhe afateve të përfshira në këtë Marrëveshje.

Referuar kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje, *shitësi 1* do të shesë dhe blerësi do të blejë aksionet dhe do të përfitojë titullin ligjor të shoqërisë Taurbeg Limited, pa ndonjë barrë, që përfshin

gjithë kapitalin e emetuar të kësaj shoqërie. Shitësi 2 do të shesë dhe blerësi do të blejë aksionet dhe do të përfitojë titullin ligjor të shoqërisë MHB Wind Farms (Holdings) Limited, pa ndonjë barrë, që përbën gjithë kapitalin e emetuar të kësaj shoqërie. Referuar shtojcës 1 të “Marrëveshje shitblerje kuotash”, shoqëria MHB Wind Farms (Holdings) Limited zotëron të gjitha kuotat edhe në kapitalin aksioner, të filialit MHB Wind Farms Limited.

Transaksioni i propozuar, konsiston në përfitim të kontrollit, nëpërmjet blerjes së aksioneve në shoqërinë MHB Wind Farms (Holdings) Limited dhe shoqërinë Taurbeg Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërive MHB Wind Farms (Holdings) Limited dhe Taurbeg Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

Statkraft Ireland Limited zotërohet 100% nga shoqëria Statkraft AS, shoqëria mëmë e disa filialeve të Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëritë target MHB Wind Farms (Holdings) Limited dhe Taurbeg Limited, janë shoqëri Irlandeze të cilat kanë në pronësi ferma operacionale të erës në Irlandë dhe nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktivitetëve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë të shoqërive MHB Wind Farms (Holdings) Limited dhe Taurbeg Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1018 , Datë 29.09. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË BOSIS DOO VALJEVO NGA SHOQËRIA DS SMITH PACKAGING SOUTH EAST GMBH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.09. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë BOSIS DOO VALJEVO nga shoqëria DS Smith Packaging South East GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të BOSIS DOO VALJEVO nga shoqëria DS Smith Packaging South East GmbH.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë BOSIS DOO VALJEVO nga shoqëria DS Smith Packaging South East GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen e kuotës”, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: DS Smith Packaging South East GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit austriak.

DS Smith Packaging South East GmbH zotërohet në mënyrë indirekte nga shoqëria DS SMITH PLC, e cila është shoqëria mëmë e grupit të shoqërive DS Smith Group.

DS Smith Group është kryesisht aktive në prodhimin dhe shitjen e ambalazheve të valëzuar në Zonën Ekonomike Europiane. DS Smith Group mbledh gjithashtu letër të përdorur dhe karton të valëzuar, për të prodhuar letër të ricikluar për ambalazhim të valëzuar. Aktivitetet e paketimit të valëzuar të DS SMITH PLC janë të përhapura në të gjithë Zonën Ekonomike Europiane.

DS Smith Group nuk ka prezencë ligjore të regjistruar në Shqipëri por ka gjeneruar të ardhura nëpërmjet

eksportimit të produkteve të ambalazhit të valëzuar nga filialet e saj në Maqedoninë e Veriut, Greqi dhe Itali.

Pala shitëse: Z. Bogoljub Pantelić, është shtetas i Republikës së Serbisë, i cili zotëron 100% kuotat e shoqërisë BOSIS DOO VALJEVO.

Shoqëria Target: BOSIS DOO VALJEVO, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Serbisë, me aksioner të vetëm Z. Bogoljub Pantelić dhe me aktivitet tregtar: prodhim i letrës dhe kartonit të valëzuar dhe ambalazheve të letrës dhe kartonit.

BOSIS DOO VALJEVO nuk është prezentë në Shqipëri, por ka realizuar xhiro nëpërmjet eksportit të kutive të valëzuar të lito-petëzuar.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë DS Smith Packaging South East GmbH (blerësi), dhe Z. Bogoljub Pantelić (shitësi), është lidhur “Marrëveshje për blerjen e kuotës”, nënshkruar më datë [...].

Referuar kësaj Marrëveshjeje, shitësi Z. Bogoljub Pantelić ka rënë dakort të shesë kuotën e tij dhe të marrë përsipër detyrimet që i ngarkohen shitësit, në varësi të kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Blerësi ka rënë dakort të blejë kuotën e tij dhe të marrë përsipër detyrimet që i ngarkohen blerësit, në varësi të kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në bazë të ligjit në fuqi, blerësi do të jetë pronar i Kuotës pasi të regjistrohet si i tillë në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Republikës së Serbisë.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria DS Smith Packaging South East GmbH do të zotërojë 100% shoqërinë target BOSIS DOO VALJEVO.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar, konstatohet se transaksioni i propozuar synon blerjen e 100% të kuotave të shoqërisë BOSIS DOO VALJEVO nga shoqëria DS Smith Packaging South East GmbH, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu për kuti të valëzuar të lito-petëzuar, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit të shoqërisë nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë BOSIS DOO VALJEVO nga shoqëria DS Smith Packaging South East GmbH.

DS Smith Packaging South East GmbH është pjesë e DS Smith Group, aktive kryesisht në prodhimin dhe shitjen e ambalazheve të valëzuar. DS Smith Group nuk ka prezencë ligjore të regjistruar në Shqipëri por ka gjeneruar të ardhura nëpërmjet eksportimit të produkteve të ambalazhit të valëzuar nga filialet e saj në Maqedoninë e Veriut, Greqi dhe Itali.

BOSIS DOO VALJEVO është aktivitet në prodhimin e letrës dhe kartonit të valëzuar dhe ambalazheve të letrës dhe kartonit në Serbi. Target nuk është prezent por ka realizuar xhiro në Shqipëri nëpërmjet eksportit të kutive të valëzuar të lito-petëzuar.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë BOSIS DOO VALJEVO nga shoqëria DS Smith Packaging South East GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1019 , Datë 29.09. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË SAUDI ARABIAN OIL COMPANY, BAOSHAN IRON & STEEL CO., LTD. DHE PUBLIC INVESTMENT FUND.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.09.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota / joint – venture, nga shoqëritë Saudi Arabian Oil Company, Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe Public Investment Fund.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Arabian Oil Company, Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe Public Investment Fund.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Arabian Oil Company, Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe Public Investment Fund.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Ortakësh”, nënshkruar më datë [...], palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala 1: Saudi Arabian Oil Company është një shoqëri aksionare, e themeluar nëpërmjet Dekretit Mbretëror të Arabisë Saudite, e angazhuar kryesisht në eksplorimin, shpimin dhe nxjerrjen e substancave hidrokarbure dhe përpunimin, prodhimin, rafinimin dhe tregtimin e këtyre substancave. Saudi Arabian Oil Company nuk ka asnjë entitet ose aktivitet të regjistruar në Shqipëri. Kjo shoqëri realizon xhiro në Shqipëri përmes tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate.

Pala 2: Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës Popullore të Kinës, e angazhuar kryesisht në prodhimin e kimikateve të rrezikshme, menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, biznesin e prodhimit, transmetimit, furnizimit të energjisë elektrike etj. si dhe në shkrirjen e çelikut dhe hekurit, përpunimin dhe petëzimin e çelikut, përpunimin e rrotullimit të metaleve me ngjyra etj.

Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. nuk është aktiv dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2022.

Pala 3: Public Investment Fund është një fond qeveritar i krijuar dhe rregulluar nga Ligji i Fondit të Investimeve Publike, i nxjerrë në zbatim të Dekretit Mbretëror të Arabisë Saudite. Ajo ka investime direkte dhe indirekte në një numër sektorësh në të gjithë Arabinë Saudite dhe globalisht, duke përfshirë ushqimin dhe bujqësinë, energjinë, sektorin financiar, prodhimin, pasuritë e paluajtshme, logjistikën dhe sektorin digjital.

Ndërmarrja e Përbashkët (JV) e propozuar nuk është themeluar ende. Ajo do të krijohet në Mbretërinë e Arabisë Saudite si një ndërmarrje e përbashkët me funksione të plota, aktive në prodhimin dhe shitjen e pllakave të çelikut të rëndë dhe hekurit të reduktuar (DRI).

II. Përqendrimi

Më datë [...], ndërmjet shoqërive Saudi Arabian Oil Company, Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe Public Investment Fund, është nënshkruar “Marrëveshje Ortakësh”.

Referuar kësaj marrëveshje, palët mendojnë të krijojnë dhe operojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Mbretërinë e Arabisë Saudite, si një subjekt që do të jetë në gjendje për të ushtruar aktivitetin në mënyrë të pavarur.

JV do të administrohet nga një Këshill Administrimi, i përbërë nga 8 administratorë (2 nga Saudi Arabian Oil Company, 4 nga Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe 2 nga Public Investment Fund). Kuorumi për çdo Mbledhje të thirrur në mënyrë të rregullt dhe për çdo mbledhje të shtyrë, do të jetë i vlefshëm nëse marrim pjesë të paktën 5 administratorë, me kusht që të paktën 1 administrator i emëruar nga secili ortak të marrë pjesë.

Ortakët do të sigurohen që shoqëria JV të mos ndërmarrë asnjë nga veprimet e mëposhtme (Çështjet unanime të Këshillit), përveçse me rezolutë të miratuar me miratimin unanimit në një Mbledhje të Këshillit të Administrimit të thirrur siç duhet ose me rezolutë të miratuar me pëlqimin unanimit me shkrim të Këshillit të Administrimit:

- i) [...]
- ii) [...]
- iii) [...]

Referuar Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi për çdo Mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme do të jetë pjesëmarrja e të gjithë ortakëve. Ortakët do të sigurohen që shoqëria JV të mos ndërmarrë asnjë nga veprimet e mëposhtme (Çështjet e rezervuara me miratim unanimit të ortakëve), përveçse me rezolutë të miratuar me vendim unanimit të ortakëve në një Asamble të Përgjithshme të organizuar rregullisht (duke përfshirë Mbledhjen e shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme):

- i) [...]
- ii) [...]
- iii) [...]

JV do të ketë të gjitha mjetet e nevojshme për të ushtruar aktivitetin në mënyrë të pavarur në treg dhe gjithashtu do të ketë një ekip të plotë administrues, për operacionet e saj të përditshme. Parashikohet që JV e propozuar të ketë akses në financim si çdo shoqëri tjetër aktive në treg, nëpërmjet financimit nga palët e treta, si dhe nëpërmjet shitjes së shërbimeve të saj.

Në përfundim të transaksionit, JV do të zotërohet 25% nga Saudi Arabian Oil Company, 50% nga Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe 25% nga Public Investment Fund.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i prekur nga transaksioni do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe shitjes së pllakave të rënda të çelikut dhe prodhimit dhe shitjes së hekurit të reduktuar, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët (Joint-Venture) me funksione të plota nga shoqëritë Saudi Arabian Oil Company, Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe Public Investment Fund. Shoqëria e përbashkët J-V do të zotërohet 25% nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company, 50% nga shoqëria Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe 25% nga Public Investment Fund.

Saudi Arabian Oil Company nuk ka asnjë entitet ose aktivitet të regjistruar në Shqipëri. Kjo shoqëri realizon xhiro në Shqipëri përmes tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate. Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. nuk është aktiv dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2022.

Public Investment Fund ka investime direkte dhe indirekte në një numër sektorësh në të gjithë Arabinë Saudite dhe globalisht.

Shoqëria JV do të krijohet në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe nuk ka plane që të jetë aktive në Shqipëri.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Arabian Oil Company, Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe Public Investment Fund.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1020 , Datë 29.09. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË ASETEVE TË BIZNESIT NË TOKË TË SHOQËRISË WINNS AS NGA SHOQËRIA STATKRAFT VARME AS.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.09. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të aseteve të Biznesit në Tokë të shoqërisë Winns AS nga shoqëria Statkraft Varne AS.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të aseteve të Biznesit në Tokë të shoqërisë Winns AS nga shoqëria Statkraft Varne AS,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi transaksionin e blerjes së aseteve të Biznesit në Tokë të shoqërisë Winns AS nga shoqëria Statkraft Varne AS.

Referuar “Marrëveshje për Blerjen e Aseteve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft Varne AS është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë. Statkraft Varne AS është një shoqëri e themeluar për zhvillimin, operimin dhe optimizmin e pompave të nxehtësisë për qendrat e biznesit dhe ato rezidenciale dhe për shpërndarjen e energjisë me qëllim ngrohjen e konsumatorëve. Statkraft Varne AS është pjesë e Grupit Statkraft, i cili zhvillon dhe operon asete të energjisë së rinovueshme që përfshin hidrocentralet, solar, gaz dhe biomasë, ofron shërbime energjie për ngrohje dhe shet dhe blen energji.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas

legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njërive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse: Winns AS është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë. Winns AS ofron produkte të ngrohjes dhe ftohjes për qendrat e biznesit dhe platformave të vendosura në det të hapur përmes modeleve konvencionale të biznesit dhe modeleve inovative si EaaS (“Energjia si Shërbim”) dhe PaaS (“Performanca si Shërbim”).

Winns AS nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Shoqëria Target: Biznesi në Tokë i shoqërisë Winns AS përfshin: aktivitetet në tokë të shitësit, modelet e biznesit, asetet e shitësit, shërbimet e biznesit të shitësit duke përfshirë dhe transferimin e punëmarrësve, sistemeve kompjuterike, kontratat me klientët dhe të çdo të drejtë dhe detyrim lidhur me biznesin duke përfshirë çdo licencë, llogari bankare dhe funksione të tjera ndihmëse.

Shoqëria Target, Biznesi në Tokë i shoqërisë Winns AS, nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Statkraft Varme AS (blerësi) dhe shoqërisë Winns AS (shitësi) është lidhur “Marrëveshje për Blerjen e Aseteve”, e nënshkruar më datë [...].

Referuar kësaj marrëveshje, Biznesi i shitësit është i ndarë në dy degë, (i) në det dhe (ii) tokë (pjesa e tokës referohet si “Biznes”).

Sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë marrëveshje, shitësi i shet blerësit dhe blerësi i blen shitësit të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin për të gjitha aktivet, pronat dhe të drejta që lidhen me ose të përdorura në lidhje me Biznesin që nga data e Përfundimit (Aktivet e Transferuara), duke përfshirë pa kufizim sa më poshtë:

- (i) Aktivet e listuara në shtojcën 3.1, ku përfshihen instalimet EaaS;
- (ii) Të gjitha të drejtat në bazë të kontratave që kanë të bëjnë me biznesin, duke përfshirë pa kufizim kontratat e renditura në shtojcën 3.2;
- (iii) Kontrata e qirasë për hapësirën e hapur të tryezës së bashkëpunimit që i përket zyrave të shoqërisë në Bergen;
- (iv) Të gjitha të drejtat e shitësit në lidhje me punonjësit e transferuar;
- (v) Të gjitha të drejtat dhe njohuritë që lidhen me Performancën si Shërbim (PaaS);
- (vi) Të gjitha të arkëtueshmet dhe të drejtat e tjera për të marrë pagesa nga çdo person që linden si rrjedhojë e biznesit;
- (vii) Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të nevojshme për ose të përdorura në lidhje me biznesin ose aktivet e transferuara, së bashku me të drejtën për të përfaqësuar tek palët e treta blerësin, pasardhës të biznesit etj.

Bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit”, parashikohet se: “Objekt i kontrollit mund të jenë një ose më shumë, ose gjithashtu pjesë të ndërmarrjeve të cilat përbëjnë njësinë ligjore, ose asetete të kësaj njësie ose vetëm një pjesë e këtyre aseteteve. Përfundimi i kontrollit mbi asetete mund të konsiderohet si një përqendrim, vetëm nëse këto asetete

përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu. Transferimi i klientelës të një biznesi mund të plotësojë këto kritere nëse kjo është e mjaftueshme për të transferuar një biznes me një xhiro në treg”.

Nga vlerësimi i dokumentacionit konstatohet se Biznesi në Tokë i shoqërisë Winns AS përbën një njësi biznesi me përfaqësim në treg, e cila krijon xhiro dhe në përfundim të transaksionit, kjo njësi biznesi do të zotërohet plotësisht nga Statkraft Varme AS.

Transaksioni i propozuar, konsiston në përfitim të kontrollit, nëpërmjet blerjes së aseteve të Biznesit në Tokë të shoqërisë Winns AS nga shoqëria Statkraft Varme AS, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ofrimit të sistemeve të energjisë për ngrohjen dhe ftohjen e ndërtesave tregtare dhe rezidenciale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit, nëpërmjet blerjes së aseteve të Biznesit në Tokë të shoqërisë Winns AS nga shoqëria Statkraft Varme AS.

Statkraft Varme AS, pjesë e Grupit Statkraft, është aktive në tregun e zhvillimit, operimit dhe optimizimit të sistemeve të ngrohjes nga pompat e nxehtësisë.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëria Target, Biznesi në Tokë i shoqërisë Winns AS, nuk është prezent dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të aseteve të Biznesit në Tokë të shoqërisë Winns AS nga shoqëria Statkraft Varme AS.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

2023

VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2023
BULETINI ZYRTAR

